

# ***Brengat e Kosovës***

*Zërat e Zgjedhësve*



DEPARTAMENTI I DEMOKRATIZIMIT

***Redaktor***

Mauro Arrigoni  
Julie Broadbent  
Hannelore Valier

***Përkthimi në gjuhën shqipe dhe redaktimi***

Blerim Berisha  
Elton Lelo

***Përkthimi në gjuhën serbe dhe redaktimi***

Emina Aliu  
Tatjana Matić

***Dizajni nga***

Nona Reuter

***Fotografitë nga***

Lubomir Kotek

# Parathënie

Mandati i Misionit të OSBE-së në Kosovë është mbështetja e zhvillimit të strukturave demokratike që përfaqësojnë kërkesat e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Zgjedhjet e Asamblesë Përgjithshme në nëntor të këtij viti do të jenë një hap përpara në rrugëtimin e Kosovës drejt demokracisë dhe një rast tepër i volitshëm për njerëzit të cilët do të marrin fatin në duart e tyre për ta shtyrë përpara kulturën e qeverisjes së mirë.

Partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile marrin ndihmë të vazhdueshme nga Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së për të zgjeruar kapacitetin organizativ dhe për të shtuar mundësitë e tyre politike e shoqërore për të propaganduar ndryshimet demokratike. Kjo broshurë është pjesë e përpjekjeve të Departamentit për të përfshirë qytetarët për së afërmi në jetën politike dhe eventualisht, për të ndërgjegjësuar politikanët dhe administratorët në lidhje me vendimet dhe veprimet tyre. Ne besojmë fuqimisht se pjesëmarrja aktive e qytetarëve në debatet politike dhe në procesin e vendimmarrjes janë pjesë përbërëse e çdo demokracie. Duke u bazuar në këtë, qëllimi i këtij raporti është tu tërheqë vëmendjen politikanëve, shoqërisë civile dhe opinionit të gjerë ndaj brengave të njerëzve në Kosovë me qëllim që të inkurajojë politikanët që tu përgjigjen kërkesave të elektoratit të tyre dhe për të marrë përsipër përgjegjësitë që u takojnë.

Një publikim<sup>1</sup> i ngjashëm është përdorur me sukses vitin e kaluar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në zgjedhjet komunale për të ngjallur dialogun në mes të politikanëve dhe elektoratit. Shpresojmë se ky raport do të kontribuojë në vetëdijësimin e liderëve të ardhshëm në lidhje me kërkesat e komunitetit.

Ka rëndësi fakti se strukturat qeverisëse të Kosovës janë gjithëpërfshirëse dhe përfaqësojnë kërkesat e shumë komuniteteve të këtushme. Ne besojmë se me 17 Nëntor 2001, të gjithë njerëzit në Kosovë me të drejtë vote do të shprehen se i takojnë aktivisht Kosovës nëpërmjet fletëvotimeve dhe kështu të marrin pjesë në krijimin e Kosovës së vërtetë demokratike, ku “të gjitha komunitetet dhe gjithkush mund të jetojë në paqe”.



**Ambasadori Daan Everts**  
ZPSSP

*Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë*

---

<sup>1</sup> Zërat e Zgjedhësve – Brenga e Komunitetit , OSBE Prishtinë 2000.



# Përmbajtja

Hyrje .....	vii
Prioritetet .....	xii
1. Ligji dhe Rendi .....	1
2. Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia .....	5
3. Shëndeti .....	10
4. Trupat mbrojtëse të Kosovës .....	14
5. Politika Ekonomike dhe Financiare .....	16
6. Qeverisja e Mirë, të Drejtat e Njeriut dhe Mundësitë e Barabarta ...	21
7. Rinia dhe Sporti .....	24
8. Mbrojtja e Ambientit .....	28
9. Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre .....	31
10. Kultura .....	35
11. Puna dhe Mirëqenia Shoqërore .....	37
12. Tregtia Brendshme dhe e Jashtme, Industria dhe Investimet .....	41
13. Mbajtja e Marrëdhënieve me Bashkësinë Euroatlantike .....	43
14. Bujësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural .....	45
15. Familja, Gjinia dhe të Miturit .....	47
16. Transporti, Posta, Telekomunikimi dhe Teknologjitë Informimative ..	49
17. Aktivitetet Administrative dhe Operacionale të Doganave .....	51
18. Administrata Lokale .....	52
19. Turizmi .....	53
20. E Ardhmja e Kosovës .....	54
Mirënjohje .....	58



# Hyrje

*“Kjo është e shkëlqyeshme, por a do ti dëgjojnë ata zërat tanë?”*

*“Shpresoj se sugjerimet tona do të ndikojnë në hartimin e agjendave të tyre!”*

Studentë nga Skenderaj/Srbica

Me 17 Nëntor 2001, njerëzit e Kosovës do të votojnë për Asamblenë e parë Gjithë-Kosovare të zgjedhur në mënyrë demokratike. Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme<sup>2</sup>, e shpallur me 15<sup>th</sup> Maj 2001 me rregulloren e UNMIK-ut 2001/9, shtjellon detajet në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e organeve të ardhshme qeverisëse të Kosovës.

Në dritën e këtyre ngjarjeve të ardhshme, doli Projekti Brenga e Kosovës, nga i cili rrjedh ky botim. Ky projekt nuk është vetëm përmbledhje e pikëpamjeve të njerëzve në Kosovë, por duhet kuptuar më parë si shprehje e demokracisë. Një nga qëllimet kryesore të këtij projekti është që t’ju ofrojë njerëzve vetëdijësim politik dhe shoqëror për përgjegjësitë e tyre në shoqërinë civile dhe tërheq vëmendjen lidhur me rolin aktiv që qytetarët mund të luajnë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tyre qytetare në mënyrë që t’i kontribuojnë procesit demokratik.

Broshura Brengat e Kosovës /Zërat e Zgjedhësve përpiqet të sfidojë partitë politike dhe kandidatët që të trajtojë çështjet prioritare për elektoratin, duke i inkurajuar gjithashtu zgjedhësit që të mbështeten tek zyrtarët e zgjedhur. Është e qartë se partitë politike mund ta përdorin këtë informacion si mjet për të drejtuar fushatën e tyre politike, dhe për të lehtësuar diskutimet dhe debatet politike në mes të partive dhe njerëzve. Përpos që të përdoret nga kandidatët, grupet qytetare dhe qytetarët gjatë fushatës zgjedhore, kjo broshurë përfaqëson një mjet verifikues për shoqërinë qytetare për të gjykuar se si veprimi i të zgjedhurve është në përputhje me kërkesat e shprehura të njerëzve.

Broshura Brengat e Kosovës është një raport që shpreh brengat e opinionit kosovar në relacion me 28 kompetencat me të cilat do të përballet Qeveria e ardhshme. Publikimi riprodhon në mënyrë verbale dhe statistike përparësitë e elektoratit të Kosovës; ai është një pasqyrë e detajuar lidhur me hapësirat në cilat opinionin i përgjithshëm kosovar beson se zyrtarët e zgjedhur duhet t’i përqëndrojnë përpjekjet e tyre. Në secilin kapitull, pranë komenteve të Kosovarëve janë disa fakte të detajizuara që i referohen disa çështjeve të diskutuara.

Stafi për demokratizim i OSBE-së ka kryer mbi njëqind takime në Kosovë, duke diskutuar me më shumë se 1.300 Kosovarë. Me qëllim për të siguruar vështrim të ekuilibruar në lidhje me të gjitha sektorët, pjesëmarrësit në takime ishin

---

<sup>2</sup> Veni re ju lutem se ne tekstin që pason është referuar si “Korniza Kushtetuese”

ftuar nga të gjitha etnitë, të gjitha grupet shoqërore-ekonomike, duke krijuar në këtë mënyrë një përzierje urbane dhe rurale, meshkuj dhe femra, të rinj e të vjetër. Në secilin takim, ndërmjetësit shkurtimisht prezantuan Kornizën Kushtetuse dhe marrëdhëniet e saj me zgjedhjet e para qëndrore gjithëkosovare, që nga lufta e Pranverës 1999. Duke bërë pyetje të ndryshme, ndërmjetësit theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve, jo vetëm në zgjedhje, por gjithashtu në debatet politike. Pastaj, pjesëmarrësve ju është shpjeguar se qëllimi i takimit ishte t'u mundësojë atyre shprehjen e shqetësimeve dhe prioritetëve të tyre kryesore në adresë të liderëve të ardhshëm brenda suazave të kornizës kushtetuese. Secili takim ishte i ndarë në dy pjesë, njëra për t'i dhënë prioritet shqetësimeve të qytetarëve dhe tjetra për diskutime. Me qëllim për t'i dhënë prioritet bregave individuale, nga pjesëmarrësit u kërkua që të plotësojnë një pyetësor, i cili përmbante të njëzetetë kompetencat që janë përshkruar brenda Kornizës Kushtetuse së bashku me një shpjegim të vogël për secilën. Nga pjesëmarrësit u kërkua që t'i japin prioritet dhjetë lamive kryesore të bregave të tyre, duke i radhitur 1 – 10, ku e para ishte çështja më e rëndësishme për ata. Pjesëmarrësit u inkurajuan që të mendojnë për tri prioritetet që ata kanë zgjedhur. Ata kishin për të shkruar, se çfarë ishin problemet specifike, çfarë veprime do të dëshironin të shihnin dhe se çfarë rezultati do të dëshironin. Pastaj, ndërmjetësuesit i kontrolluan të gjithë pyetësorët, llogaritën numrin total të pikave të dhëna në secilën kompetencë dhe duke renditur pesë prioritetet kryesore të grupit si tërësi. Këto kompetenca pastaj u prezantuan në takim për tu diskutuar.

Në përgjithësi, atmosfera në takimet ishte pozitive, shumica e njerëzve ishin të gatshëm t'i shprehin mendimet e tyre dhe aq më shumë kishte shumë komente, që sugjerorin se opinioni e mirëpriti rastin për të propozuar idetë e veta. Kishte shpresë se politikanët do t'i shqyrtonin komentet e tyre. Shumica e takimeve u zhvilluan në atmosferë të gjallë dhe konstruktive. Në disa takime të jo Shqipëtarëve kishte diskutime të vështira dhe interesante, pasi që pjesëmarrësit shfrytëzuan rastin të shprehin pakënaqësitë e tyre ndaj Komunitetit Ndërkombëtar dhe për të diskutuar perceptimin e tyre për Kornizën Kushtetuese, si dhe për situatën në komunat përkatëse.

Broshura, njofton për komentet verbale, të 20 kompetencave statistikore të cilat u transmetuan nga publiku në takimet tona. Radhitja e prioritetëve të të pranishmëve reflektohet në radhitjen e kapitujve dhe mund të shihen në formë statistikore në faqen xii.

Porosia e prioritetëve është e qartë: të gjithë Kosovarët i vlerësojnë shumë lart kompetencat e Ligjit dhe Rendit, Shëndetit, dhe Arsimit. Në të vërtetë këto janë tri prioritetet kryesore, përpos në takimet me jo Shqipëtarët ku në mënyrë predikuese këto tri radhiten nën prioritetin kryesor, të Drejtat e Komuniteteve. Për shumicën jo Shqipëtare të Kosovës, të Drejtat e Komunitetit janë brenga kryesore, që shërben si bazë për perspektivë në kompetencat tjera. Për popullatën e Kosovës është e qartë nevoja e shtimit të rritjes së shoqërisë qytetare, për t'i çuar qytetarët në drejtim të një ardhmërie stabile.

Kjo mund të arrihet vetëm me anë të Arsimit, ku njerëzit respektojnë dhe pajtohen të jetojnë nga rregullat e njejta, duke e shmangur hutinë dhe kaosin. Kjo që pason është një përmbledhje e dhjetë çështjeve kryesore të diskutuara në takimet e mbajtura.



Prioriteti i radhitur më së larti është Ligji dhe Rendi. Kosovarët mendojnë se Ligji dhe Rendi nevojitet si çështje urgjente për të bërë një Kosovë stabile dhe pa probleme, ku shoqëria paqësore dhe qytetare mund të jetojnë së bashku në harmoni.

Sidoqoftë, ka një dallim themelor në trajtimin e çështjes së Ligjit dhe Rendit në mes të komuniteteve. Komuniteti Shqipëtar i Kosovës njehon Ligjin dhe Rending me hapin pozitiv drejt aspiratave për një Kosovë të pavarur. Ndërsa për komunitetin joshqiptar rritja e Ligjit dhe Rendit do të sigurojë stabilitet në Kosovë, që do të mundësonte liri më të madhe të lëvizjes dhe më shumë qetësi.

Ligji dhe Rendi për komunitetet joshqiptare në Kosovë kuptohet si parakusht për të siguruar të drejtat e komuniteteve përkatëse. Të gjithë kosovarët janë të brengosur me rritjen e krimit dhe efektet e tij në komunitet, posaçërisht të rinjtë, dhe për pasojat shoqërore-ekonomike. Shumë herë u përmend se rritja e kompetencave për shërbimin policor të Kosovës, poashtu përpjekjet për të krijuar ambient më të favorshëm ekonomik, do të duhet të përballen me krimin. Ekonomia e varfër sjell papunësinë, e cila shkakton krimin, dhe ky krijon korrupsionin, një fenomen që duhet ndaluar.

Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia janë prioriteti i dytë i radhitur më lart. Është bindje e fortë se popullata mirë e arsimuar mundet vetëm ti kontribuojë një shoqërie produktive mirë të organizuar. Problemi me sistemin me të cilin njerëzit në Kosovë ndeshen është mungesa e qasjes në program të mirë arsimues. Kjo fillimisht është rezultat i burimeve të varfëra, por gjithashtu u diskutua gjendja e rrogave të mësuesëve dhe pregaditja profesionale e tyre që shumë njerëz besojnë se është e vjetruar. Kosovarët nga viset rurale dhe Kosovarët nga enklavat shprehën brengën e tyre të madhe për qasje të pamjaftueshme në Arsim në krahasim me Kosovarët që jetojnë në qytete.

Shëndeti është prioriteti i tretë me radhë. Secili që diskutoi për shëndetin, përshkroi kushtet e këqija të shërbimit shëndetësor. Mungesa e lokaleve, të pajisjeve themelore dhe mungesa e stafit të motivuar profesional, janë temat që përsëriten në takime. Kosovarët besojnë se kujdesi shëndetësor është përgjegjësi themelore për qeverinë dhe se duhet të ndërmerren veprime të menjëherëshme.

Kishte edhe akuza për korrupsion, shpesh njerëzit citonin pamundësinë e marrjes së barnave nga klinikat publike, duke qenë se i njëjti mjek i posedonte ato në klinikën e tij private. E njëjta ndodh edhe në Arsim, kosovarët nga viset rurale dhe kosovarët nga enklavat përshkruan vështirësitë në shfrytëzimin e kujdesit themelor shëndetësor.

Trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK) janë prioriteti i katërt në radhë. Kjo çështje së pari është diskutuar vetëm brenda komunitetit shqiptar i cili shprehu dëshirën që TMK të jetë ushtria e Kosovës. Diskutimet dhe shumica e propozimeve ishin jashtë suazave të Kornizës Kushtetuese.

Politika Ekonomike dhe Financiare ishin kompetenca e pestë në radhë. Të gjithë u pajtuan me faktin se ekonomia është shkaktori kryesor i shqetësimeve të tyre. Pasoja më e madhe e ekonomisë së varfër është efekti i saj shkatërrues ndaj punësimit. Zgjidhja është e ndarë në dy mendime të ndryshme, prona shtetërore përkundrejt privatizimit. Të gjithë ishin të mendimit se pasiguria politike në Kosovë pengoi investimet e jashtme. Tatimi, huatë e vogla për biznesin e vogël dhe investimet e huaja ishin tri propozimet kryesore konkrete nga Kosovarët për

të mundësuar rindërtimin e ekonomisë së shkatërruar.

Qeverisja e Mirë, të Drejtat e Njeriut dhe Mundësitë e Barabarta, përbënin brengën e gjashtë të qytetarëve. Shumë pjesëmarrës në takimet e komunitetit pohuan se këto koncepte janë thelbësore për shoqërinë demokratike. Një propozim konkret është dhënia e kompetencave për gratë në vendin e punës. Përgatitja profesionale dhe ekonomike mundet ti shërbejë së tepërmi shoqërisë. Komunitetet pajtohen me faktin se nevojitet transparencë brenda sistemit politik. U shpreh gjithashtu nevoja për mbështetje nga liderët e zgjedhur dhe gjithashtu nga ata që mbajnë poste të larta administrative. Kosovarët duan të dinë se si dhe pse është krijuar politika e vendimmarrjes. Shumë prej tyre, gjithashtu e dinë rolin që ata mund ta luajnë si individë apo në shoqata.

Rinia dhe Sporti ishin prioriteti i shtatë. Në Kornizën Kushtetuese këto janë definuar në një kompetencë, që shpesh e humbte kahjen e diskutimeve gjatë takimeve. Ankesa më e madhe është se nuk ka vend të mjaftueshëm apo ndonjë aktivitet që i është dedikuar vetëm të rinjve. Shumica e popullatës së Kosovës është nën moshën 26 vjeç. Gjithandej porosia është e qartë, rinia kërkon mirënjohje, respekt dhe përfshirje në zhvillimin e shoqërisë.

Mbrojtja e Ambientit është prioriteti i tetë. Kur shoqëria përballet me probleme serioze ekonomike, politike dhe shoqërore mbrojtja e ambientit nuk kuptohet kurrë si brengë primare. Sidoqoftë, politikanët duhet të gjejnë mënyrat se si të përmirësohet situata aktuale, sepse shumë njerëz gjithmonë e më shumë brengosen për mbeturinat në rrugë, dhe për ndotjen e ajrit dhe ujit.

Në përgjithësi, të Drejtat e Minoriteteve përbënin prioritetin e nëntë. Për jo Shqipëtarët kjo kompetencë është brenga më e rëndësishme, dhe u rendit ndër çështjet prioritare. Të drejtat e Komunitetit janë kërkesa e tyre vitale dhe shërbejnë si pikë nisjeje për t'u bazuar të gjitha kompetencat tjera. Në Komunitetin Shqiptar kjo çështje është ende brengë serioze. Në mënyrë specifike të rinjtë mesatarisht e radhitën atë si prioritetin e tyre të gjashtë duke kërkuar me elokuençë të drejta të barabarta për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kultura është prioriteti i dhjetë. Njerëzit brengosen për mungesën e vendeve adekuate për të organizuar ngjarje kulturore. Arsyja pse kjo çështje ka tërhequr vëmendjen në masë të madhe, është se njerëzit në përgjithësi identifikojnë kulturën me aktivitetet rekreative. Shumë njerëz përpiqen të mbështesin dhe të promovojnë kulturën kosovare veçanërisht në kontekstin e globalizimit të shoqërisë.

Komentet në këtë broshurë janë vetëm mendime të Kosovarëve dhe nuk reflektojnë pikëpamjet e OSBE-së dhe të redaktorëve. Ky publikim është raport i bazuar në pyetësorët dhe diskutimet e bëra në takimet e komunitetit dhe nuk pretendojnë të jenë studime sasiore apo cilësore të bazuara në shkencë. Sidoqoftë, ky publikim mund të përdoret si doracak i përgjithshëm për të definuar se cilat janë brengat kryesore politike për qytetarin e rëndomtë të Kosovës.


Njëzetetë përgjegjësitë e paraqitura në Kornizën Kushtetuese janë:

1. Të Drejtat e Komunitetit dhe Antarëve të tyre
2. Politika Ekonomike dhe Financiare
3. Çështjet Fiskale dhe Buxhetore
4. Aktivitetet Doganore Administrative dhe Operacionale
5. Tregu Vëndës dhe i Huaj, Industria dhe Investimet

6. Arsimi, Shkenca dhe Teknologjia
7. Rinia dhe Sporti
8. Kultura
9. Shëndeti
10. Mbrojtja e Ambientit
11. Puna dhe Mirëqenia Shoqërore
12. Familja, Gjinia dhe të Miturit
13. Transporti, Posta, Telekomunikimi dhe Teknologjitë e Informimit
14. Shërbimet Administrative Publike
15. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural
16. Statistika
17. Planifikimi Hapsinor
18. Turizmi
19. Qeverisja e Mirë, të Drejtat Njerëzore dhe Mundsitë e Barabarta
20. Çështjet për Refugjatë
21. Administrata Lokale
22. Çështjet Juridike
23. Mas Mediat
24. Emergjenca dhe Gatishmëria
25. Marrëdhëniet e Jashtme
26. Zhvillimi i Marrëdhënieve Euro-Atlantike
27. Ligji dhe Rendi
28. Trupat Mbrojtëse të Kosovës

# Prioritetet

Gjatë takimeve, ne ju dhamë pjesëmarrësve pyetësorin me 28 fushat prioritare të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohëshme. Ata duhet të emëronin 10 më të rëndësishmet, duke i renditur në bazë të rëndësisë. Për të vlerësuar rëndësinë e prioriteteve, i pari kishte 10 pikë, 9 i dyti, deri tek i dhjeti nga rëndësia me 1 pikë. Pikët e 1316 pyetësorëve të plotësuar u llogaritën së bashku, për të na dhënë një rezultat mesatar (prej 0 deri 10) për secilën çështje të ligjit dhe Rendit Publik.



## LIGJI DHE RENDI

*“Pa një sistem të strukturuar mirë të Ligjit dhe Rendit, nuk ka zhvillim demokratik.”*

Kamenicë/Kamenica, banorë

Ligji dhe rendi përbëjnë brengën më të madhe të Kosovarëve. Kjo çështje sistematikisht paraqitet në pesë prioritetet kryesore për të gjitha komunitetet etnike. Sidoqoftë, perspektiva e ligjit dhe rendit dhe arsyeja, pse ata janë prioritet kryesor dallon në mes të Shqiptarve dhe joshqiptarve. Për komunitetin shqiptar, është e qartë se respektimi i ligjit dhe rendit është kusht themelor për funksionim të mirë të shoqërisë. Porosia nga takimet me shqiptarët është e qartë, nevojiten ligje të forta për të qeverisur me sukses dhe kjo është mënyra e vetme për të arritur pavarësinë; ligji dhe rendi është prioritet për udhëheqjen dhe funksionimin e shtetit, dhe për ndërtimin e vendit.

Komuniteti Serb pajtohet që ligji dhe rendi është kusht themelor për funksionim të mirë të shoqërisë, porse këto prioritete duhet të përmirësohen për të arritur stabilitet më të madh. Në mënyrë më specifike, për të gjithë jo Shqiptarët, ligji dhe rendi konsiderohen si mjete për të mundësuar liri më të mëdha të lëvizjes dhe si mënyrë për të garantuar të drejtat e komunitetit të tyre. Të gjitha komunitetet shprehin dëshirë të fortë për shtimin e ligjit dhe rendit për të krijuar shoqëri paqësore dhe të lumtur ku njerëzit mund të jetojnë të lirë.

Ekziston bindje e fortë se kur ka ligj, dhe rend, secili e kupton rolin e vet, dhe atëherë komuniteti mund të përparojë. Ligji dhe rendi janë gurë themeltarë për stabilitetin dhe ardhmërinë e Kosovës: “Më shumë ka nevojë për ligje sesa për bukë. Ne po vdesim për ligje,” sugjeron një qytetar i Klinës/Klina. Kur ka ligj dhe rend, atëherë shoqëria mund të fokusohet në çështjet tjera, si Arsimi dhe Shëndeti. Shpesh njerëzit flasin për nevojën e një baze më të fortë ligjore në Kosovë. Është thënë se kjo është me rëndësi të madhe për stabilitetin në regjion. Bindja është se ligji dhe rendi i fortë do ta krijojnë një Kosovë pa probleme në të ardhmen. “Pa ligj dhe rend, nuk ka paqe dhe ardhmëri për Kosovën, me ligje të mira dhe paqe, Kosova do të shkoj drejt ardhmërisë” beson një qytetar nga Kaçaniku/Kaçanik.

### Zhvillimi Ekonomik

Ligji dhe rendi janë të lidhur shpesh në mënyrë specifike me zhvillimin ekonomik<sup>3</sup> “Ligji dhe rendi janë parakusht për zhvillimin ekonomik” thotë një

---

<sup>3</sup> Shih gjithashtu kapitullin për politikën ekonomike dhe financiare.

qytetar nga Peja/Pec. Qytetarët mendojnë se situata e rëndë politike i largon investitorët e jashtëm, dhe kështu vazhdon situata e papunësisë. Dhe një nga pasojat e papunësisë së madhe është krimi. Kështu, rrethi vicioz vazhdon. Një shoqëri paqësore dhe konform ligjit mund të ketë vetëm efekt pozitiv në zhvillimin e ekonomisë.

### **Efektet anësore të krimit**

Një brengë e madhe në opinionin publik janë paligjësitë evidente në shoqëri që vihen re në Kosovë dhe ndikimi i tyre në liritë dhe të drejtat e njeriut. Në të vërtetë, mendohet se vetëm me anë të pushtetit e ligjit shoqëria mund ta arrijë respektimin e drejtave dhe lirive të njeriut. Me qëllim përmirësimin e aspekteve të tjera të jetës, duhet që njerëzit së pari të ndjehen të lirë dhe të sigurtë. Në kohët e fundit, perceptimi i përgjithshëm është se po dominon krimi, është vështirë për të siguruar shoqëri të lirë dhe demokratike nëse nuk ekzistojnë institucionet efektive dhe efikase për të mbrojtur qytetarët e Kosovës. Veçanërisht, njerëzit fajësojnë mungesën e pushtetit qendror për mosfunksionimin e ligjit.

Një grua e re nga Gjakova thotë, “Prostitucioni, droga, trafikimi i njerëzve dhe kidnapimet s’kanë të ndalur. Kriminelët ecin të lirë në rrugë”. Të gjitha këto krime në mënyrë sistematike u shtruan në takimet e komunitetit. Gjithashtu, në një takim në Malishevë/Mališevo u diskutua për numrin e madh të armëve. “Të gjitha armët duhen dorëzuar, sepse për momentin nuk na duhen dhe shpresoj se nuk do të na nevojiten më” thotë një grua në këtë takim.

Është brengë e madhe rritja e veprave kriminale pasi besohet se policia po i toleron ato. Mungesa e respektimit të ligjit po sjell kontrollimin e veprimtarive kryesore dhe të rëndësishme të biznesit nga grupet e korruptuara, duke e çuar shoqërinë në rrugën e tmerrshme të anarkisë. Besohet se vetëm një grup i caktuar i shoqërisë po shkakton problemet kryesore kriminale në Kosovë.

Një pronare e shitores nga Gllgovci flet për shtimin e krimit të organizuar dhe se kriminelët kërkojnë të holla nga pronarët e shitoreve. Gjithashtu u tha se, mungesa e ligjit të fortë, po mundëson që Kosova të bëhet udhëkryq i kriminalitetit në Ballkan.

Një grup i grave në Gllgovc thotë se situata e tashme e gruas në regjionin e tyre është brengosëse. Ato gjithashtu thanë se ka pasur disa raste të dhunimit dhe të ushtrimit të dhunës ndaj grave. “Vajzat nuk janë të sigurta në rrugë” thotë një grua në Gjakovë.

Njerëzit thonë se keqpërdorimi i drogës është problem me rëndësi. Të gjitha komunitetet janë të brengosura, duke pasur parasysh pasojat saj e për gjeneratën e re. “Situata është alarmuese, dhe, nëse nuk bëhet asgjë, do të kemi një gjeneratë të rinjsh jo të shëndetshëm” thotë një banor nga Kamenicë/Kamenica, banor.

Kishte kërkesa, në disa takime për përmirësimin e legjislacionit të punësimit, veçanërisht për të mbrojtur të punësuarit aktualë. “Punëtorët trajtohen si skllëvër “thotë një student i Universitetit të Prishtinës. Studentët tjerë thonë se njerëzit në pozita të larta, shefat dhe drejtorët shpesh i shfrytëzojnë zbrazëtitë e ligjit për punë dhe i keqpërdorin pozitat e tyre. Në të vërtetë, disa studentë mendojnë se legjislacioni i ligjit dhe i rendit duhet të fokusohen në luftimin e korrupsionit.” Korrupsioni në ndërmarrjet e mëdha shtetërore, si Spitalet, KEK apo personeli në shërbimet doganore duhet të ndalet”.

## **Sistemi Juridik**

Bindja e përbashkët është se kriminelët e dënuar nuk marrin denimin që u takon, prandaj duhet krijuar sa më shpejt një legjislacion të ri. Rregullisht u theksua se Policia duhet të krijojë prioritete në detyrat e saj. Shumë komunitete besojnë se policia ishte përqendruar më shumë në komunikacion sesa në krimet më serioze si p.sh. trafikimin e drogës. U tha se një sistem i mirë gjyqësor funksional është baza për shoqërinë e lirë. Gjithashtu, u tha se Gjykatësit dhe autoritetet tjera që kanë të bëjnë me sigurimin, duhet të paguhen më mirë me qëllim që të jenë të motivuar, dhe poashtu për të parandaluar korrupsionin brenda institucioneve gjyqësore.

Një sistem i pavarur gjyqësor, i cili duhet të përfshijë një sistem të pavarur dhe të fortë të apelit, u përmend shpesh. Një grua nga Vitia/Vitina beson se “kriminelët duhet të gjykojnë nga gjykatësit ndërkombëtarë”. Të gjitha komunitetet kërkojnë të bëhet më shumë për ti shkarkuar gjykatësit e korruptuar. Duhet të rritet numri i Gjykatësve ndërkombëtarë dhe i Prokurorëve për t’i mbështetur Gjykatësit vendas, të cilët jo vetëm janë të njëanshëm por aq më tepër shpesh kërcënohen nga të akuzuarit.” Gjykatësit duhet të mbikëqyren nga ndërkombëtarët,” mendon një xhentëlmen nga Skenderaj/Srbica.

Një propozim koherent që rrodhi nga takimet është rritja e përgjegjësive dhe kompetencave të Shërbimit Policor të Kosovës dhe jo vetëm fillimi i procesit të ndërtimit të kuadrove. Në këtë mënyrë bashkëpunimi me të gjitha komunitetet do të ishte më i thjeshtë. Mungesa e legjislacionit adekuat çon në mungesën e efikasitetit të organeve ekzekutive. Shpeshherë përmendet nevoja e rritjes së rrogave paralelisht me rritjen e autoritetit të tyre, si dhe nevoja e trajnimit të mëtejshëm. Sipas një avokati nga Kamenica “Pagat e ulëta të policëve ndikojnë negativisht në efektivitetin e punës së tyre.”

### **Parandalimi i krimit**

Në një takim në Gjakovë u diskutua për parandalimin e krimit për të krijuar besueshmëri për të ardhmen. Arsimi është përmendur si më i rëndësishëm dhe më shumë kohë duhet ti kushtohet nëpër shkolla mësimi të efekteve shoqërore të kriminalitetit si dhe për pasojat personale të atyre që thyejnë ligjin. Veçanarisht, lidhur me parandalimin e drogës, një buurë nga Prishtina/Pristina sugjeron se në shkolla duhet të studiohen efektet negative të drogës; gjithashtu u përmend edhe mungesa e institucioneve për rehabilitimin e njerëzve që janë të varur nga droga.

### **Roli i individit**

Disa komunitete brengosen për moskuptimin e ligjit dhe mungesën e informacionit për ligjin e aplikuar, qoftë ai ligj jugosllav apo rregulloret e UNMIK-ut. U theksua edhe hutia rreth ndarjes së kompetencave në mes të KFOR-it, Policisë UNMIK-ut dhe SHPK.” Kjo huti dhe përzjerje duhet të qartësohet,” kërkon një fermer nga Kamenica/a. Një Goran i Dragashit/Dragas thotë “Ne nuk i dimë ligjet e aplikuar”.



---

## Faktet për ligjin dhe rendin

---

- Deri tani janë diplomuar 3.845 rekrutë nga Shkolla Policore e Kosovës dhe 267 pjesëmarrës janë duke e ndjekur kursin e 16 të.
- Momentalisht 4.384 Policë të UNMIK-ut janë në detyrë në Kosovë (Raporti i Cimic-ut Korrik 2001) Buxheti i vitit 2001 do ti mundësojë forcës policore blerjen e një flote të vogël por moderne të veturave dhe të sigurojë një numër të shërbi-meve mbështetëse (cfr.Buxheti i Kosovës)
- Kriminaliteti i të rinjve është ende i ulët, por është fenomen në rritje. Shumica e krimeve që kryejnë të miturit 14-18 vjeç janë vepra agresive, vjedhje, vrasjet dhe dhunimet. Përkundër opinionit të krijuar vetëm 5% e krimeve të të rinjve kanë të bëjnë me drogën. Gjatë këtij viti diku 50 të rinj 14-18 vjeç janë privuar nga liria.(UNMIK/JIAS Departamenti për Mirëqenie Shoqërore).
- Shumica e krimeve të bëra në Kosovë janë: Djegjet e shtëpive (28%), sulmet agresive(20), vrasjet (13%) kidnapimet (10%), që më të shpeshta janë në regjio-nin e Prishtinës/Pristina dhe Gjilanit/Gnjilane (cfr Raportet eCimic 2001)
- Numri i përgjithshëm i krimeve në periudhën Janar 2000 dhe Gusht 2001 është vazhdimisht rreth 500 për një javë (UNMIK/JIAS Departamenti për Mirëqenie Shoqërore).
- Në vitin 2001 numri i vrasjeve, djegieve, dhe vjedhjes së veturave është në rënie, ndërsa vjedhjet nëpër shtëpi dhe sulmet janë në rritje (Policia e UNMIK-ut )
- Numri i të burgosurve vazhdon të rritet në shkallë të papërmbajtur. Numri i përgjithshëm në fund të Qershorit 2001 ishte 624: kjo do të thotë se në fund të Verës nuk do të ketë vende për të burgosur (cfr. Raportet e Cimic 2001).
- Numri i Gjykatësve dhe zyrtarëve të Gjyqit do të rritet kur të krijohen kushtet në Departamentin e Drejtësisë dhe Sistemit Ligjor. Është planifikuar që në fund të vitit 2001, 52 Gjyqe të jenë plotësisht funksionale (cfr.Buxheti i Kosovës2001)





# ARSIMI, SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA

*“Pa Arsimim të duhur nuk do të jemi në gjendje ta zhvillojmë ekonominë dhe të bëhemi udhëheqës të mirë.”*

Mësues nga Kaçaniku/Kaçanik

Ardhmëria e demokracisë, ekonomisë, zhvillimi dhe mirëqenia e përgjithshme në shoqërinë moderne e të qytetëruar janë të lidhur drejtëpërsëdrejti me nivelin e arsimimit të qytetarëve të saj. Pjesëmarrësit në takime ishin plotësisht të vetëdijshëm për këtë përgjegjësi themelore, duke radhitur arsimin si prioritet kryesor dhe si porosi evidente për pushtetin e ardhshëm. Qeveria e ardhshme duhet të punojë shumë për të përmirësuar gjendjen momentale të arsimit, që është vlerësuar si shumë e palakmueshme.

Arsimi është konsideruar si mjete më i mirë për zhvillimin individual dhe kolektiv. Një rom nga Gjilani/Gnjilane deklaroi, “tregëtia mund të bëhet individualisht por Arsimi i duhet Qeveria”. Zhvillimi dhe arritjet e dëshirueshme në arsim, do të kontribuojë gjithashtu në zbutjen e problemeve shoqërore si papunësia dhe kriminaliteti. Mësuesit janë gati të vetmit që kanë rastin për ti mësuar nxënësit disa rregulla themelore të bashkëjetesës, posaçërisht në aspektin emocional të dinamikës shoqërore të jetës në grup.

## **Pa arsim nuk ka ardhmëri**

“Mungesa e arsimit e ka degraduar popullatën dhe humbur kujdesin për traditën dhe fenë tonë,” ose “arsimimi është garanci për punësim” janë mendimet e shprehura shpesh në takimet e komunitetit. Shumë parime të shoqërisë moderne, si respekti për pushtetin e ligjit apo zhvillimi ekonomik janë të lidhura me funksionimin e mirë të sistemit të arsimit.” Nëse kemi arsimim të shëndoshë, kemi poashtu shtet të shëndoshë, përndryshe do të kemi shoqëri të dominuar nga kaosi dhe mosrespekti” shton drejtori i shkollës nga Kamenica/a. Si rezultat të mundshëm njerëzit do të donin të shihnin gjithashtu rritjen sasiore e cilësore të nivelit të kulturës dhe që kjo të mos jetë e kufizuar vetëm në qytetet e mëdha.

## **Reformat, metodat e mësimi dhe pajisjet**

“Kushtet e shkollimit këtu në Prishtinë/Pristina nuk janë të pranueshme” mendon një drejtor shkolle “Ne duhet implementojmë një planprogram për shkollim, sepse qëllimi ynë është ti bashkohemi Europës dhe duhet të mendojmë

se si të diplomuarit dhe diplomat të njihen nga vendet Europiane.”

Përkundër faktit se njerëzit besojnë se vështirësitë në sistemin arsimor rrjedhin nga shumë probleme, ata konsiderojnë se niveli profesional i mësuesve është i ulët, gjë që u shtohet rrethanave të palakmueshme në të cilat ata duhet të punojnë. Mungesa e pajisjeve shkollore, lokaleve adekuate, sidomos laboratorët shkencorë dhe teknologjia e informimit, bibliotekat, orënditë dhe fushat e sportit janë brenga serioze. “Vlerësimi i kërkesave duhet të bëhet në nivel komunal e pastaj të dërgohet drejtpërdrejt në pushtetin qendror i cili duhet të ndër marrë diçka” (mësues nga Gjakova/Djakovica)

Në thelb ka marrëveshje që të ndërmerren reforma themelore, të përmirësohen shkathësitë pedagogjike dhe didaktike të mësimdhënësve dhe të ardhurat e mësuesve të jenë të arsyeshme. Reforma duhet të ndërmerren edhe për sigurim e pajisjeve moderne në shkolla me qëllim për të bërë metodat e mësimi më dinamike dhe të përpikta. “Kërkohet rishikimi i plotë i përgatitjes profesionale, duke përfshirë zvogëlimin e numrit të lëndëve në shkollimin e mesëm dhe në nivel të Universitetit. Duhet të mbështetet bashkëpunimi me studentë nga Universitetet Europiane,” sugjeron një grua nga Gjakova/Đakovica.

Një grua në Prishtinë/Priština kërkon nga të gjithë mësuesit dhe profesorët “të zvogëlojnë numrin e lëndëve dhe ligjëratave, jemi të stërngarkuar, është sistem i vjetëruar, pra duhet ta reformojmë. Bëjeni atë të thjeshtë dhe të saktë”.

“Si mund ti impletojmë reformat nëse na mungon 70% e lokaleve për të organizuar klasët gjegjëse?” pyet një drejtor në Prishtinë/Priština dhe shton “për të krahasuar sistemin tonë të shkollimit me modelet Perëndimore, duhet që së pari të normalizojmë orarin e punës që secili nxënës të fillojë mësimin në ora 08.00 dhe ta mbarojë në orën 16.00 në vend se të punohet në tre ndërrime”. Kërkesë e vazhdueshme është se duhet të përmirësohen kushtet e mësimdhënësve, së pari duke ju rritur rrogat e mësuesëve. “Rrogat e mësuesëve dhe profesorëve janë gati në nivelin e ndihmës sociale, “thotë një fermer nga Tuxhevc. Në kushte të tilla është vështirë të kërkosh më shumë motivim nga mësuesit dhe profesorët, të cilët me të vërtetë punojnë jo për para por për idealizëm”.

### **Shkollimi në viset rurale**

“Të gjithë duhet të gëzojnë të drejtën e barabartë për shkollim në të gjitha nivelet dhe në gjuhën e tyre. Duhet që të ketë një plan dhe program të përbashkët për shkollim” (Goran nga Gllloboçica, Dragash/Dragaš).

Në të gjitha viset e Kosovës duhet të ketë mundësi të njejta për tu shkolluar në nivel të njejtë. Siç pohon një i ri në Deçan/Decani “parlamenti i ardhshëm duhet të ndër marrë çdo masë për të siguruar që shkollimi në viset rurale të jetë po aq i mirë sa edhe në viset urbane”.

Në të vërtetë disa prindër në viset rurale druhen se niveli i shkollimit në fshat nuk mund të jetë aq i mirë sa ai në qytete. Kështu ata druhen se fëmijët e tyre do të lihen anash, jo vetëm për shkak të largësisë në mes tyre dhe qyteteve më të afërta, por gjithashtu për shkak të cilësisë së dobët të shkollimit.

Në viset rurale mungesa e burimeve materiale është brengosëse sidomos në nivelin e mesëm,” të rinjtë shumë shpesh janë të detyruar ta ndërprejnë shkollimin për shkakë të mungesës së mjeteve materiale për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit ditorë në qytetë” (një nënë nga Shtimja/Stimlje). Në enklava të rinjtë denoncuan vështirësitë e mëdha për të studiuar në ndonjë institucion aka-

demik. Një student nga Zubin Potoku u ankua për vështirësitë gjatë studimeve: “U larguam nga universiteti dhe shkuam në Serbi, ku nuk na ofrohen kushtet themelore për të punuar: pa orendi, pa kompjuterë dhe mundësitë tjera”.

Një grua e re nga Mitrovica/Mitrovica, e cila studjonte në Prishtinë/Pristina thotë, “tani fakulteti është në Blace, por për shkak se nuk mund të udhëtoj shpesh dhe vështirësisë për ti siguruar librat, me siguri se nuk do ti përfundoj studimet akademike”.

Aktivitetet shkollore shtesë brenda dhe jashtë shkollave janë gjithashtu të nevojshme. “Sistemi shkollor duhet të filloj me gatishmërinë për ti pajisur prindërit me kulturë të re duke i mësuar ata që ti dërgojnë fëmijtë e tyre në shkollë” (Ashkali në Podujevë/Podujevo).

### **Mundësitë për shkollim**

Për shkak të numrit të kufizuar të studentëve që mund të pranohen në Universitet, procedurat e regjistrimit nuk janë transparente dhe në disa raste u konsideruan si të pa drejta dhe jo të rregullta. “Korrupsioni është i pandalshëm kur fillon regjistrimi në Universitet” pohon studentin nga Gjakova/Djakovica .

Duke qenë se shkollimi është e drejtë thelbësore në shoqëri, çdonjëri duhet të ketë mundësinë e njejtë dhe qasje të lehtë në sistemin arsimor, duke përfshirë mbështetje për studentët që kanë nevojë më shumë. “Fakti se ne jemi fizikisht të hendikepuar nuk do të thotë se ne nuk meritojmë të shkollohemi”, pohon një i ri nga Shipoli. (Mitrovicë/Mitrovica). Në Gjakovë/Djakovica një nxënës foli për mungesën e mësuesve të kualifikuar dhe mjeteve financiare, si dhe mungesën e programeve për të ndihmuar personat e hendikepuar që të kyqen në aktivitetet e përditëshme shkollore. “Nuk ka mundësi qasjeje në shkolla për fëmijtë e hendikepuar, që i pengon ata të marrin pjesë në shkolla”.

Pjesëmarrja në procesin arsimor për femrat në viset rurale, poashtu duket të jetë çështje ndërmyjetësimi për liderët politik. “Shkalla e analfabetizmit është ende e lartë në mesin e femrave në viset rurale, kjo krijon varësi në familje, që pengon emancipimin e tyre” pohon një grua nga Deçani/Decane. Shkollimi është prioritet kryesor për një grua Shqipëtare në Bare (Leposaviq/Leposavic) e cila shpreh brengosje të thellë për përqindjen e vogël të femrave të shkolluara: “të jesh e pa shkolluar në fillim të shekullit 21, ndihem si e hendikepuar”.

---

## **Faktet për arsim, shkencë dhe teknologji**

---

- Departamenti i Arsimit dhe Shkencës mbulon pjesën më të madhe të shërbimeve publike në Kosovë. Pjesa e tij në buxhetin e konsoliduar të Kosovës është 28%.
- Së fundi në Kosovë janë ndërtuar rreth 100 shkolla dhe janë pajisur me orendi dhe pajisje, më shumë se 200 janë rehabilituar. Nuk do të mbahet më mësim nëpër tenda (UNMIK/JIAS Departamenti për Arsim dhe Shkencë)
- Ka diku 23.000 mësues, dhe 6.000 staf administrativ dhe mbështetës për 400.000 nxënës në 800 qendra arsimit. (UNMIK/JIAS Departamenti për Arsim dhe Shkencë)
- Vetëm 2.8% të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël mund të shfrytëzojnë qendrat për kujdesin e fëmijëve ose parashkollore. Shkollimi i detyrueshëm në Kosovë tani është 6 deri 15 vjeç. Sektori i shkollës së mesme ka një kapacitet prej 76.000 nxënësve. Universiteti i Prishtinës është i vetmi institucion i lartë shkollor publik.

Përmban 14 fakultete dhe gjashtë degë në komunat regjionale (shkolla të larta). Rreth 18.500 studentë dhe mbi 1.600 anëtarë të stafit studjojnë dhe punojnë në Universitet. Shkollimi i domosdoshëm special është nën-sektori më i vogël, që përfshin 8.000 nxënës.

- Modeli i vjetër (9 vjet Filllore dhe 3 vjet të Mesme) është ndërruar dhe tani do të jetë modeli 5 plus 4 plus 3 vjet. Trajnimi i mësuesëve do të luajë rol qendror dhe do të jetë shtytje për reformat, duke krijuar ekspertët, aq të nevojshëm për implementimin e sistemit të ri.
- Paga e mësuesit në shkollën fillore që punon me orar të plotë është 291 DM në muaj (UNMIK/JIAS Departamenti i Arsimit dhe Shkencës).
- Shkalla e analfabetizimit në Kosovë për brezin më të vjetër se 10 vjeç është 6% ku 83% janë femra. 71% e personave më të vjetër se 14 vjeç kanë kryer shkollën fillore dhe të mesme, 9% kanë shkollim të ndryshëm të lartë (UNMIK/JIAS Departamenti i Arsimit dhe Shkencës).

---

### **Intervistë me Prof.Dr. Michael Daxner** ***Bashkëkryesues i Departamentit për Arsim dhe Shkencë***

---

#### ***Cilat janë sfidat më të mëdha në reformimin e sistemit arsimor në Kosovë?***

Qëndrimi i punëtorëve të arsimit ka ndryshuar vetëm pjesërisht, dhe zëvendësimi i elitës intelektuale nuk është bërë ende. Reformat janë pranuar si instrument i nevojshëm për ta realizuar këtë, por ato ende nuk janë përqaftuar si mundësi për të ndryshuar konceptin e shoqërisë. Por ka shumë sfida të tjera themelore: na duhen shumë më tepër para, dhe na duhen pikërisht tani; duhet ti përmirësojmë pagat e mësuesve dhe strukturat shoqërore, ose do të mbesim pa mësues të kualifikuar; ne duhet të përfundojmë ndërtimin e shkollave dhe programin rehabilitues brenda vitit të ardhshëm.

#### ***Shumica e njerëzve ankohen se niveli i shkollimit në Kosovë është shumë i ulët, a pajtoheni me këtë?***

Po, pajtohem. Niveli është i ulët, dhe fatmirësisht, shumë njerëz tani po e kuptojnë se ata ishin të 'mashtruar' kur i referoheshin standardeve të mëparshme të shkollimit. Posaçërisht femrat janë diskriminuar sikur të ishin fëmijë të paaftë. Sot do të kisha sugjeruar se një fillim i ri është më i qëlluar se sa vazhdimësia e traditave të diskutueshme të shkollimit. (Në fillim të misionit, unë nuk i pashë qartë mangësitë e mitit tradicional të shkollimit).

#### ***A ka ndonjë tendencë për privatizimin e Universitetit? Nëse po, si do ta gjykonti atë?***

Jo. Nëse do të ketë propozime për një universitet të ri apo ndonjë institucion privat shtesë, ligji do të garantonte procedurat transparente.

Në shumë takime të komunitetit njerëzit thanë se motivimi i mësuesëve është i ulët sepse paga e tyre nuk është adekuate. A pajtoheni?

Po, unë e thashë më lart. Por ne përballemi me dy probleme, jo vetëm me një: na duhen më shumë mësues dhe të kualifikuar më mirë, ky është problemi më urgjent. Dhe duhet ti paguajmë në mënyrë adekuate, përndryshe të kualifikuarit do të vazhdojnë që të largohen.

Nga ana tjetër, ne s'mund ta ndryshojmë politikën e pagave, sepse kjo e fundit do të përfshihet në të ardhurat e Kosovës, të cilat duhet të jenë përgjegjëse për shërbimet publike që nga viti i ardhshëm. Donatorët ndërkombëtarë duhet të na ndihmojnë në arsim dhe në fushat tjera jetike.

Shkollat do të kishin pasur rol të rëndësishëm në ndërtimin e shoqërisë qytetare.

### ***Si i shihni mundësitë dhe sfidat në Kosovë ?***

Shkollimi na duhet jo vetëm për të luftuar papunësinë. Duhet të krijohet një klasë politike, e cila do të zëvendësojë idealet e heroit dhe shqiptarit virtual me figurën e nxënësit të zellshëm europian. Gjeneratat e reja janë lodhur nga udhëheqjet e regjimeve shumë autoritare dhe të cekëta të "Lordëve" të dikurshëm, të cilët nuk kanë lidhje direkte me jetën dhe biografitë e njerëzve të rinj. Dëgjoj shumë pakënaqësi të fshehura, të cilat mund të bëhen agresive, sepse nuk kanë mundësinë e shprehjes së koncepteve jetësore .

### ***Si do të doni ta shihni sistemin e shkollimit të Kosovës në pesë vitet e ardhshme?***

Pas 5 vjetësh, rrjeti arsimor regional nuk do të jetë i bazuar në bazat e shtetit kombëtar.

Por ai do të jetë i ndërthurur në një rrjet mjaft të gjërë rajonal, ku shkëmbimi i lokacionit dhe specializimi ofrojnë mundësi më të mira për të gjitha grupet etnike. Unë besoj më shumë në konceptet mbi kombëtare se sa në integrimet e detyruara.



## SHËNDETI

*“Nëse nuk je i shëndetshëm nuk mund të kujdesesh për asgjë.”*

Një grua e re nga Podujeva/Podujevo

Popullata e shëndetshme është parakusht për një shoqëri të shëndoshë. Shëndeti është një nga përgjegjësitë për qeverinë e ardhshme, që shpesh u shqua si prioritet kryesor. Sistemi i kujdesit shëndetësor është konsideruar si shumë joadekuat: mungesa e pajisjeve, shërbime jo të mira themelore, mungesa e lokaleve dhe stafi i jomotivuar profesional janë disa nga arsytet e përmendura si sqarim përse njerëzit brengosen seriozisht. “Shëndeti nuk pret dhe të drejtat e njerëzve në kujdesin shëndetësor janë rrezikuara për shkak të mungesave të ndryshme” (Goran nga Gilloboçica) Një banor i Istogut/Istok, është i brengosur se çdo ditë paraqiten sëmundje të ndryshme të reja dhe infeksione, që duan kujdes të menjëhershëm, por mungesa e pajisjeve e vështirëson kujdesin.

Gjithashtu njerëzit mendojnë se ndotja e ajrit është burim i sëmundjeve. “Në fshat nuk ka kanalizim dhe ujë të pijshëm, kjo i kontribuon përhapjes së sëmundjeve,” thotë motra medicinale 26 vjeçare nga një fshat afër Malishevës. Në Plemetin, mbeturinat nëpër rrugë dhe kontejnerët tejet të mbushur janë faktor i rrezikshëm për shëndetin, posaçërisht të fëmijëve.

Është thënë se çështjet shëndetësore nuk mund të zgjidhen individualisht, por janë një detyrë thelbësore për qeverinë, e cila duhet ta marrë përsipër përgjegjësinë për të ndërmarrë masa adekuate për të përmirësuar gjendjen e tashme të vështirë. Shëndeti është hapi kryesor për Kosovën dhe duhet të përfshihet në prioritetet kryesore për liderët e ardhshëm politikë” (një plak nga Sibofci i Epërm). “Shëndeti është shumë i rëndësishëm për çdo popullatë kudo, në Kosovë tani kemi kushte shumë të këqija shëndetësore dhe shumë gjëra duhet të ndryshojnë. Është afati i fundit për pushtetin për të ndërmarrë diçka, duke filluar që nga spitalet shtetërore dhe shtëpitë e shëndetit”(Gazetar nga Prishtina).

### **Spitalet, klinikat dhe personeli mjekësor**

Njerëzit brengosen shumë për kushtet e këqija të klinikave, spitaleve dhe ambulancave kirurgjike. Ata thanë disa herë se pagat e mjekëve janë shumë të vogla dhe për këtë arsye ata nuk janë plotësisht të motivuar; qendrat mjekësore janë shpesh të stërbushura dhe qasja në shërbimet mjekësore në disa vise rurale është e vështirë. Pacientët duhet të caktojnë terminin, në vend se të presin me orë të tëra. Duhet që pagat e personelit mjekësor të rriten për të parandaluar që disa mjekë ti detyrojnë pacientët të shkojnë në ambulancat e tyre private”



(Një person nga Gjilani/Gnjilane). Në Kamenicë/a është propozuar që të krijohet sigurimi i obligueshëm shëndetësor dhe social për të punësuarit.

Drejtori i shkollës në Tuxhevc thotë “ shumë gjëra mungojnë, kontrollet e përgjithshme janë shumë të shtrenjta dhe askush nuk ka sigurim shëndetësor; nuk kemi mjek të përhershëm në fshat dhe kështu qasja ndaj kujdesit mjekësor është shumë e kufizuar dhe e vështirë”. Natyrisht, situata e tashme politike ndikon dhe qartazi pengon qasjen ndaj kujdesit shëndetësor. Mjekët duhet ti ndihmojnë të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh përkatësin etnike dhe fetare, konform betimit të Hipokratit, por fatkeqësisht realiteti është se njerëzit, që nuk i takojnë shumicës, kanë vështirësi të pranohen nga mjekët shqiptarë.

Ky problem i qasjes së lirë ndaj shërbimeve të shëndetit është i lidhur ngushtësisht me zonën e parë të përgjegjësisë të paraparë në Kornizën Kushtetuese, të Drejtat e Komunitetit dhe anëtarëve të tij: “po ti kishim të drejtat si komunitet, do ti kishim edhe të drejtat tjera” (një Rom në Prizren). Një Ashkali në Fushë Kosovë/Kosovo Polje propozon krijimin e klinikave multietnike, duke theksuar se mjekët shqiptarë dhe serbë do të duhej të punonin së bashku, “Kur kjo është e mundur për punëtorët e sigurimit, pse nuk do të ishte e mundur për intelektualët?”

### **Sigurimi privat dhe publik shëndetësor**

Në përgjithësi, Kosovarët pajtohen me faktin se kujdesi shëndetësor nuk mund të jetë thjesht çështje biznesi, se kujdesi mjekësor nuk duhet të jetë çështje e parave ku vetëm të pasurit kanë mundësi shërimi. Vështirësitë aktuale në sistemin e kujdesit shëndetësor çojnë në disa trajtime mjekësore që mund të ofrohen vetëm në klinikat private. “Në disa klinika private dhe shtëpitë e shëndetit mund ti gjesh të gjitha, por në shtëpitë shëndetësore publike çdo gjë mungon, bile edhe barnat më themelore,” pohon një grua nga Prishtina/Pristina. Ekziston bindja se diçka nuk është në rregull me sistemin shëndetësor, siç thonë disa vetë pasi përkundrejt standardit shumë të ulët shëndetësor në Kosovë ka shumë mjekë të mirë. Pohohet se kushtet në zonat e minoritetit janë më të këqija se sa në pjesën tjetër të Kosovës dhe se njerëzit kanë probleme serioze që të kujdesen për shëndetin e tyre. “Komuniteti ynë ka mbi 3.000 banorë dhe nuk kemi stacion shëndetësor. Kemi pasur tri raste të vdekjes së fëmijve, të helmuar me një mbi-dozë gjatë trajtimit kundër morrave, për shkak të mungesës së mjekut i cili do të kishte përshkruar dozën e lejuar”(Ashkali nga Podujeva/Podujevo).

### **Mjekësia parandaluese**

Në disa takime njerëzit shtruan çështjen se disa probleme shëndetësore shkaktohen nga mungesa e informacionit shëndetësor. Shkollimi i detajuar në fushën e shëndetësisë, apo në përgjithësi një fushatë e mirë informative për popullatën do të kontribuonte në mënyrë të dukshme në përmirësimin e kushteve shëndetësore publike. Mjekësia parandaluese është e mirënjohur, e fuqishme me kosto të ulët dhe efikase.

“Për të përmirësuar shërbimet normale shëndetësore, nuk të duhen vetëm spitale dhe mjekët, por poashtu edhe kujdesi i përditshëm shëndetësor, mundësitë e ushtrimeve fizike, edukimi shëndetësor dhe mjetet tjera parandaluese”(një burrë në Dobrotin) Një i ri nga Obiliqi/Obilic thekson “se në gjithë Kosovën duhet organizuar fushatë të vaksinimit nëpër shkolla për të çrrënjosur disa sëmundje të nxënësve që më parë”. Një grua në Pejë/Pec gjithashtu thekson rëndësinë e

edukimit të rinisë përmes”vetëdijësimit shëndetësor me anë të mediave”.

Masa specifike janë sugjeruar nga një grua në Deçan/Decani: “departamenti i shëndetit publik duhet të nisë fushatë për vetëdijësimin publik për disa sëmundje relevante të grave që janë mjaft të përhapura në Kosovë dhe momentalisht po e rrisin shkallën e vdekshmërisë së gruas për shkak të mungesës së parandalimit. Shoqatat e grave mund të shërbejnë si pikë fokusimi për departamentin me qëllim që të lehtësojnë përhapjen e informatave për shëndetin e grave në zona të ndryshme” Një grua në Pejë/Pec informon “shumë gra nuk janë të vetëdijshme për disa sëmundje apo për probleme shëndetësore, si për shembull kanceri gjirit i cili mund të trajtohet lehtë dhe të shërohet në fazën e hershme, nëse informacioni vjen në kohën e duhur.

### **Kujdesi shëndetësor në viset rurale**

Shumë pjesëmarrës në takime theksuan mungesën e shërbimeve shëndetësore në viset rurale, edukimin shëndetësor dhe objektet shëndetësore. Shpesh duke thënë se praktikisht nuk ka spitale, nuk kryhen vizitat e specialistëve në terren (pediatra dhe gjinekologë ),dhe ilaçet e shtrenjta, sidomos për njerëzit me sëmundje kronike. “Nuk ka specialist në Novo Bërdë” raporton një grua “infermieret nuk paguhen rregullisht dhe nuk ka personel në detyrë gjatë natës. Njerëzit janë shumë të varfër për të shkuar në Prishtinë/Pristina apo në Gjilan/Gnjilane vetëm për një injekcion”. “Për mua si nënë, cilësia e shërbimeve shëndetësore që ju ofrohen fëmijëve tanë në fshat është shumë me rëndësi. Për shkak të kushteve të varfëra ekonomike në viset rurale, ne nuk kemi gjithnjë para për të blerë barnat. Për këtë arsye shpresoj se pushteti i ardhshëm do të kujdeset për këtë çështje jetësore duke u munduar të gjejë një zgjidhje të arsyeshme”(banor nga Deçani/Decane)

Duke ju përgjegjur pyetjes”Si është gjendja në fshatra?” një grua nga Rahoveci/Orahovac tregon se zakonisht njerëzit nuk kanë para për të paguar për vizitë dhe presin deri në momentin e fundit, kur situata me të vërtetë keqësohet. “Duhet të jenë me të vërtetë të sëmurë për të shkuar te mjeku. Përndryshe ata nuk shkojnë diku tjetër, përdorin barnat që kanë në shtëpi, pa marrë parasysh se a kanë afat përdorimi apo jo”.



---

## **Faktet për Shëndetin**

---

- Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin e Shëndetësisë në Kosovë është 13.600, prej tyre 2.100 janë mjekë, 6.200 motra medicinale, 360 dentistë, 50 farmacistë, 290 mami dhe 4.610 personel tjetër. Shifrat – pos për personelin administrativ dhe mbështetës -janë të vogëla. Në Europë, Kosova ka një ndër përqëndrimet më të vogla të mjekëve dhe infermiereve.(UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore)



- Shumë njerëz në Kosovë kanë mundësi të kufizuara për shërbime shëndetësore për shkak të kushteve gjeografike dhe ekonomike. Banorët nga enklavat dhe zonat e minoriteteve përballen me kufizime më të mëdha se shumica, për shkak të arsyeve të sigurisë dhe restriksioneve konsekuente të lëvizjes (shih Qasja ndaj Kujdesit Shëndetësor në zonat e minoriteteve” Organizata Botërore e Shëndetit, Maj 2001)
- Sistemi Kosovar i shëndetësisë orientohet nga trajtimi spitalor dhe farmaceutik, dhe më pak me profilaksi dhe me infermiere. Kompetencat lokale në planifikimin e shëndetësisë, mënyrën e zhvillimit dhe ekonominë e shëndetësisë janë të vogla. (UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore)
- Spitalet përballen me mungesën e ujit , rrymës, ngrohjes, dhe mbeturinat e spitaleve. Numri i përgjithshëm i mjekëve në spitale është i vogël, posaçërisht ndihet mungesa e specialistëve. Furnizimi me barna është jo i rregullt.
- Përhapja e tuberkulozit është e lartë -77 raste të reja në 100.000 banorë. (UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore , shih gjithashtu kapitullin për Mbrojtja e Ambientit ).
- Rreth 15% e grave shohin punëtorin shëndetësor vetëm para lindjes dhe 30% të tyre përfitojnë nga një apo dy vizita. Deri 50% të lindjeve bëhen në shtëpia pa ndihmë mjekësore (UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore).
- Vdekshmëria e foshnjave është rreth 25 për 1.000 foshnja të lindura (UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore).
- Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore ka trajnuar grupin e parë prej 102 mjekëve nga gjitha viset e Kosovës për Mjekësin Familjare (CIMICREP 816,12 July 2001).

***Mjekët, infermieret dhe shtretërit spitalorë në Kosovë dhe Europë:***

	Mjekë per 100'000	Infermieret per 100'000	Shtretërit spitalor Per 100'000
Europë	346	772	728
Kosovë	139	361	278

***Institucionet kryesore shëndetësore (të dhënat nga UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Shoqërore)***

Institucioni	Number
Spitali Univerzitar	1
Spitalet Regjionale	5
Shtëpitë e Shëndetit (poliklinika të mëdha)	29
Ambulancat (qendrat e vogla të ndihmës së parë)	234
Qendrat Rehabilituese	2
Spitalet e Tuberkolozit	2
Instituti i Shëndetit Publik	7

## TRUPAT MBROJTËSE TË KOSOVËS (TMK)

Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë renditur të katërtat në listën e prioritetëve, kështu që për to është diskutuar pothuajse në të gjitha mbledhjet, përkatësisht edhe në mbledhjet me pjesëtarët e Komunitetit Shqiptar të Kosovës, të cilët shfrytëzuan rastin që të diskutojnë në lidhje me atë që dëshirojnë të jetë TMK në të ardhmen përkundrejt asaj që është tani.

Kjo ka qenë një çështje njaft e vështirë në diskutimin me komunitetet jo-shqiptare, të cilat vinin theksin më tepër në realitetin e jetës së tyre të përditshme si të kundërvënë ndaj ndjenjave për një institucion të tillë si TMK.

Ndërmjetësuesit gjatë takimeve e patën të vështirë ta mbanin diskutimin brenda temës që kishte të bënte me rolin që luan TMK në përputhje me kornizën kushtetuese. Një njeri nga Klina përmbloodhi shkurtimisht rrjedhën e shumicës së takimeve duke thënë: “TMK nuk është prioritet në kuadrin e një force civile, ajo do të jetë një ushtri e mirëfilltë sapo për këtë të piqen kushtet”. Në fakt, gati në të gjitha mbledhjet pjesëmarrësit vinin në dukje rolin e TMK brenda kontekstit të saj si ushtri. Shumica theksonin faktin se TMK mund të luajë një rol efektiv në sigurimin e ligjit dhe rendit në Kosovë duke qenë se ajo duhet të shndërrohet në ushtri të rregullt. Shumica ngulnin këmbë në dhënien e mbështetjes së mjaftueshme financiare, statutit dhe fuqive ligjore do që ta plotësonin këtë. “Ata përfaqësojnë ushtrinë e Kosovës” thotë një i ri nga Skenderaj. Një student nga Fushë Kosova thotë se ai “ka pritur që TMK të jetë një ushtri e vërtetë që do të siguronte rendin.” Përfaqësuesit e komuniteteve vazhdimisht kanë përkujtuar ndërmjetësuesit se TMK edhe më herët ka qenë një ushtri e suksesshme dhe se ky fakt ka legjitimuar rolin e saj, për këtë arsye ajo meriton të trajtohet me respekt. Në mes tjerash është përmendur shpesh fakti se komuniteti ndërkombëtar duhet të luajë rolin e vet në trajnimin e TMK dhe të ndihmojë në rritjen e profesionalizimit të saj ushtarak. Në përgjithësi ideja për të pasur një ushtri profesionale ka qenë e lidhur ngushtë me çështjen e pavarësisë. Një grua nga Vitia thotë se “Nuk ka shtet pa ushtri”. Një student nga Peja/Pec thotë: “Nëse shteti nuk ka ushtri, për mua kjo nuk është shumë e arsyeshme”

Në disa raste të rralla, diskutimi mbi TMK qëndronte përbrenda kufijve të një ekipi civil të gatishmërisë për reagim urgjent. Theksi u vu më tepër në çështjen e furnizimit me pajisje dhe të sigurimit të trainimeve me qëllim që të mund të përballohen emergjencat e mundshme. “Nëse ka vërshimë në Gjakovë, si do të jetë e mundur që ata të shkojnë shpejt atje dhe të shpëtojnë njerëzit?” pyet një

mësues nga Prishtina. Poashtu është shprehur shqetësim në lidhje me pagat e vogla të anëtarëve të TMK, pasi kjo ka efekt negativ në motivimin e tyre, duke marrë parasysh se shoqëria pret nga ata që të rrezikojnë jetën e tyre në zjarre dhe vërshima për të mirën e të tjerëve.

Një shqiptar nga Dragashi deklaroi se TMK duhet të ketë edhe përfaqësues nga etnitë e tjera në përbërjen e saj. Këtë mendim ai e ndan edhe me një mjeke shqiptare nga Prishtina, e cila thotë: “Unë do të thoja se në TMK duhet të marrin pjesë edhe pakicat tjera, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Ne nuk duhet të jemi vetiakë dhe të mbajmë vetëm shqiptarë në TMK, të gjitha grupet tjera duhet të përfshihen, kjo është mënyra më e mirë për të krijuar një shoqëri multietnike.”

---

## **Të dhëna mbi Trupat Mbrojtëse të Kosovës**

---

- Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë formuar zyrtarisht nëpërmjet emërimit të 46 udhëheqësve të saj kryesorë me 21 janar të vitit 2000. TMK përbëhet nga trupat aktive që numërojnë 3.000 anëtarë dhe një trupë ndihmëse prej 2.000 anëtarësh. Dhjetë përqind të anëtarëve të tyre duhet të rekrutohen nga mesi i komuniteteve të pakicave (Programi trajnues i TMK-së, Organizata Ndërkombëtare për Emigrim IOM). Numri aktual i TMK-së është 4.510 (raporti I CIMC, Gusht 2001); shumica e 500 vendeve për pakica ende mbesin për t'u mbushur (shih [www.un.org/kosovo](http://www.un.org/kosovo)).
- TMK përgatit propozime për trajnime nën udhëheqjen e stafit rajonal. 42 projekte janë aprovuar nga të cilat 22 janë të përfunduara. TMK-ja ka shpenzuar 125.000 orë fuqi punëtore për realizimin e projekteve. Ata kanë qenë të suksesshëm gjatë ndërmarrjes së projekteve të përbashkëta me organizata të ndryshme humanitare që veprojnë në Kosovë (Programi i trajnimit të TMK-së IOM)
- Mesatarja e pagës mujore e një anëtari aktiv të TMK-së është 292 DM (shih [www.un.org/kosovo](http://www.un.org/kosovo)).

# POLITIKA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

*“Ekonomia është karburanti për të gjitha degët e tjera të shoqërisë.”*

Grua nga Ferizaj/Uroševac

Politika Ekonomike dhe Financiare ka qenë një temë e vazhdueshme e diskutimeve në mbledhje. Unanimisht është konkluduar se gjendja ekonomike e Kosovës është një çështje mjaft brengosëse. Ekonomia është një çështje komplekse; lidhur me mënyrat e trajtimit të kësaj çështjeje u shprehën mjaft pikëpamje të ndryshme.

Shumica e e njerëzve me të cilët është diskutuar, favorizonin formën e shpejtë të privatizimit, mirëpo disa njerëz ende përkrahin ringjalljen e ndërmarrjeve shoqërore. Të dy metodat janë cituar si zgjidhje për papunësinë e cila është diskutuar në të gjitha mbledhjet, si një pasojë e madhe shoqërore e politikës ekonomike aktuale. Të gjithë anëtarët e komuniteteve përkrahin faktin se një ekonomi e shëndoshë shkon krahas me një demokraci të shëndoshë dhe se ka rëndësi vendimtare për të rinjtë dhe për ardhmërinë e Kosovës. Një Ashkali nga Podujeva/o thotë se “Implementimi i politikës ekonomike dhe financiare deri më tani nuk ka arritur të plotësojë kërkesat e popullsisë”.

## **Ekonomia e shkatërruar**

“Rifillimi i sektorit të ekonomisë në Kosovë nuk është i lehtë, duke marrë parasysh se gjithçka është e shkatërruar” thotë një student nga Skenderaj/Srbica. “Ekonomia është në nivel zero” dhe ajo ka qenë e “dobët dhe e pazhvilluar” për një periudhë shumë më të gjatë, mendon një i ri nga Ferizaj. Këta janë vetëm dy shembuj në mesin e shumë komenteve të ngjashme, të cilat janë paraqitur gjatë mbledhjeve të komuniteteve. Shumë njerëz diskutojnë se po të mos ishte politizimi aktual i shoqërisë së tyre, kjo do të ishte shqetësimi numër një për shumicën e popullatës. “Vetëm tregu i zi është duke funksionuar” thotë një grua nga Gjakova/Djakovica. Pamja e përgjithshme e ekonomisë së shkatërruar, papunësia e lartë si dhe mungesa e teknologjisë moderne është duke gjymtuar çdo formë të tregut të lirë. Mungesa e teknologjisë moderne shpesh herë është paraqitur si problem thelbësor.

Pranimi i faktit se ekonomia e Kosovës është në fazën e tranzicionit është i qartë, dhe komentet ilustrojnë faktin se shoqëria është e vetëdijshme për kaosin e pashmangshëm dhe efektet anësore negative të cilat rrjedhin prej kësaj. Një

ekonomist nga Kamenica/a thotë se “disa grupe mund të krijojnë klika mafioze.” Një grua nga Dragashi/Drigas beson se “krijimi i një sistemi ekonomik dhe financiar të fortë do të ndalte korrupsionin dhe se atëherë shoqëria do të mund të shkonte në drejtimin e duhur. Një ekonomi e fortë sjell rezultate edhe në fushat e tjera të shoqërisë; ajo gjithashtu shërben si parakusht për një shoqëri të shëndoshë në përgjithësi me efekte pozitive në ligj dhe rend. “Në mënyrë që të arrihen rezultate të mira në të gjitha fushat, është e domosdoshme që të mbizotërojë një gjendje e mirë ekonomike” thotë një teknik nga Peja/Pec.

### **Papunësia**

Në një mbledhje në Pejë u diskutua papunësia e lartë në këtë komunë. Kjo e fundit vjen nga fakti se shumica e fabrikave të mëdha në këtë rajon kanë ndalur veprimtarinë. “Ne jemi në një situatë në të cilën kërkesa për punë dhe për të ardhura është urgjente, duke qenë se 6.000 njerëz në Pejë janë në rrugë” informon një grua në këtë mbledhje. Një burrë nga Zubin Potoku shpjegon se sa e lartë është shkalla e papunësisë. Ai vë në dukje se nuk ka prodhim për arsye të mungesës së lëndës së parë. Ai thotë “duke u ofruar njerëzve mundësi për të fituar të ardhura për të rritur standardin e tyre të jetesës, do të rritej në mënyrë të dukshme shkalla e pavarësisë së tyre” Një grua nga Shtërpca flet mbi atë se si progresi ekonomik mund të ndihmojë në procesin e pajtimit. “Zhvillimi ekonomik do të zgjidhte shumë probleme; ekonomia në mes komuniteteve do t’i afronte njerëzit me njëri-tjetrin.” Në këtë takim Serbët e Kosovës kërkuan investime më të mëdha për komunitetet jo-shqiptare.

Efektet anësore të papunësisë njihen mirë: “devijimi shoqëror” thotë një punëtor nga Kaçaniku/Kacanik, “shëndeti i dobët” shprehet një tjetër nga Prizreni. Mjaft fuqishëm ndihet se të rinjtë janë se tepërmi nën ndikimin e këtyre efekteve të papunësisë, të cilat shpesh sjellin tensione shoqërore duke shkaktuar përdorimin e alkoolit dhe dhunën shtëpiake. “Në trurin e të papunit djalli bën vezë” është komenti emocional i një njeriu nga Kaçaniku/Kacanik.

Në Isnqi, fshat në komunën e Deçanit/Decani, pjesëmarrësit në takime shpjegojnë se shkalla e papunësisë është mjaft e lartë për arsye se shumica e banorëve para luftës kanë qenë të punësuar në sektorin bujqësor. Tani aktiviteti bujqësor ka rënë dhe kjo për shkak të mungesës së pajisjeve dhe farërave, si edhe për shkak të çmimit të lartë të punës së krahut. Një grup i grave në Deçan/i pohon se “shumica dërmuese e grave në rajonet rurale janë të papuna”, përkundrajt faktit se shumica e kanë përfunduar shkollimin dhe disa madje edhe edukimin universitar. Një grua nga Gjakova/Djakovica shprehet në lidhje me gratë e papuna “ne jemi duke u ballafaquar me një marginalizim shoqëror dhe po humbim pavarësinë në familje për shkak të papunësisë” Një grua nga Deçani/Decan sugjeroi se zyrtarët e zgjedhur duhet të inkurajojnë nismat e grave në zonat rurale, të cilat mund të krijojnë punë dhe të ndihmojnë zhvillimin e ekonomisë në nivel fshatit. “Shumica e grave kanë ide të mira, por kanë nevojë për mbështetje financiare për fillimin e aktiviteve, zyrtarët e zgjedhur duhet të zhvillojnë një program përkrahës për gratë biznesmene.”

### **Si të aktivizohet ekonomia?**

Shumë njerëz mbështesin ringjalljen e fabrikave me pronësi shtetërore. Në një mbledhje në Skenderaj/Srbica pjesëmarrësit diskutuan lidhur me hapjen e fabrikave të mëdha. Një burrë i papunë thotë, “të gjithë ne punonim në Trepçë,

kjo është puna që ne e dimë ta bëjmë” Një burrë nga Skenderaj/Srbica është i mendimit se veprimet e menjëhershme duhet të përqendrohen në sigurimin e vendeve të punës, duke qenë se të gjithë njëzëri pajtohen se kjo duhet të bëhet nëpërmjet procesit të ringjalljes së kompanive shoqërore. Tërhoqi vëmendjen shprehja e një të riu nga Podujeva/o: “riaktivizoni gjigantët industrialë.”

Ky koncept është përkrahur edhe nga një grup njerëzish në Vushtrri/Vucitrn të cilët besojnë se për të ngjallur ekonominë në rend të parë duhet të fillojnë punën gjigantët; si të tillë ata përmendin Trepçën, Feronikelin, EXTRA, KEK-un dhe Llamkos-in, etj.

Idetë tjera anonim kah privatizimi sa më i shpejtë i mundshëm, në mënyrë që të ndihmohet një sistem më produktiv ekonomik. Një grua nga Istogu/Istok thotë “Privatizimi është më se i nevojshëm.” Një burrë nga Peja/Pec thotë se mënyra për të ecur përpara nuk është duke adaptuar një politikë retroekonomike ndaj sistemit të vjetër. Ai është i sigurtë se “përpjekjet duhet të përqendrohen në një politikë ekonomike të orientuar në një të ardhme moderne, dhe jo në fabrikat e stilit të vjetër.”

Shumë njerëz kanë theksuar se politika fiskale në të ardhmen duhet të jetë në të njëjtën kahje me modelet perendimore. “Rezultati i dëshiruar është një model evropian për ekonominë e Kosovës” thotë një i ri nga Ferizaj/Uroševac. Një njeri nga Dragashi/Drageas insiston: “Politika ekonomike duhet të jetë e bazuar në privatizim dhe në treg të lirë.” Pronësitë si edhe bizneset shoqërore shpesh herë mund të krijojnë organizata të mëdha burokratike në të cilat askush nuk ka ndjenjë të përgjegjësisë e cila më vonë ndikon në motivimin e punëtorëve. Një deklaram i fuqishëm erdhi nga një ekonomist nga Kamenica/a “Unë nuk pajtohem me faktin se mbajtja e pronave shoqërore nënkupton edhe kujdesin më të madh ndaj pronave nga vetë punëtorët.”

Shoqëria është pronë është e gjithkujt, mirëpo kurrë flitet në terme të shkatërrimit dhe të tjetërsimit, ajo nuk i përket askujt.”

Një infermiere nga Gjakova/Djakovica kërkonte që “të ketë më shumë legjislacion mbi privatizimin” duke theksuar “mungesën e ligjeve, të cilët do të transformonin pronësinë shtetërore në pronësi private.” Një përfaqësues i një OJQ-je lokale poashtu nga Gjakova/Djakovica mendon: “Nëse ne transformojmë pronësinë shtetërore në pronësi private, atëherë investitorët potencialë do të investojnë lirisht, gjë që do të ndikonte pozitivisht në uljen e papunësisë”

Ekziston një opinion mjaft i përhapur sipas të cilit zyrtarët e rinjë të zgjedhur duhet të stimulojnë më shumë zhvillimin ekonomik duke mbështetur krijimin e e ndërmarrjeve të reja dhe të vogla. Mikrokreditë për mbështetjen e bizneseve të vogla mund të “ushqejnë” ndërmarrjet e vogla; sistemi bankar duhet të ofrojë kredi biznesi. Një grua nga Podujeva/a thotë se gradualisht donatorët duhet të shkëmbehen me investitorët. Një grua nga Shtërpca/Strpce sugjeron se më shumë investime dhe më shumë vëmendje do të duhej t’u kushtohet bizneseve të vogla lokale. Zyrtarët e zgjedhur duhet “të gjejnë tregje për produktet e komunitetve” Një burrë nga rajoni i Deçanit/i përkrah një ide të tillë, pasi ai mendon se në nivelin qendror dhe në atë komunal duhet të hartohet një program për zhvillimin e mikrobizneseve, duhet të adaptohet një plan për sigurimin e përdorimit maksimal të burimeve natyrale të disponueshme në regjion .

Mbizotëronte një ndjenjë e përgjithshme se në Kosovë ka mjaft profesionistë

dhe ekspertë biznesi, të cilët do të mund të kontribuonin shumë për ekonominë. U përmend se këta njerëz shpesh ndodh që nuk flasin gjuhën angleze dhe pikërisht për këtë arsye e humbasin pozitën kundrejt njerëzve më të rinj dhe me më pak përvojë. “Njerëzit me përvojë profesionale janë të pushuar nga puna vetëm për arsye se nuk flasin gjuhën angleze, gjersa ata që janë të papërvojë, mirpo që flasin anglisht, janë të pranuar” thotë një student nga Gjakova/Djakovica. Dhe një banor i Kaçanikut thekson se “Ne kemi një potencial të madh si ekonomik ashtu edhe njerëzor.”

Gjithashtu u fol mbi atë se si shoqëria duhet të përpiqet të inkurajojë biznesmenët, të cilët aktualisht punojnë jashtë vendit, të kthehen në Kosovë, dhe që, njëkohësisht, njerëzit me aftësi profesionale që ndodhen në vend të inkurajohen për të qëndruar këtu. Një banor nga Peja/Pec sugjeroi se zyrtarët e zgjedhur duhet të inkurajojnë dhe të aktivizojnë potencialin shkencor që tashmë ekziston në Kosovë si dhe të përpiqen që t’i motivojnë kuadrot e tilla të qëndrojnë këtu. Një grua nga Kaçaniku/Kacanik kërkonte që ekspertët e zhvillimit ekonomik dhe të çështjeve financiare të punësohen.

### **Bashkëpunimi me kompanitë e huaja**

“Mungesa e kapitalit, e lidhur drejtpërdrejt me investimet e kufizuara ndërkom-bëtare, përbën një problem më vete” shfaq bindjen e tij një aktor nga Gjakova/Djakovica. Pothuajse në të gjitha mbledhjet në të cilat është diskutuar kjo çështje, njerëzit shprehnin shqetësimin e tyre mbi pamundësinë e se joshjes së investitorëve të huaj, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se situata aktuale politike paraqet një pengesë. Investitorëve u duhet siguria. Pa besim dhe garanci asnjë kapital i huaj nuk do të vijë në Kosovë. Një i ri nga Kaçaniku beson se “Pa një ekonomi dhe pa një politike të arsyeshme financiare si model, asnjë ndërmarrje perëndimore nuk do të investojë para në Kosovë”, “Ne kemi shumë fabrika këtu, por jo investime nga Unioni Evropian” thotë një grua nga Gjakova/Djakovica.

### **Tatimet**

Në përgjithësi, shumica ka përshtypjen se tatimet duhet të paguhen pasi nga një pikëpamje e përgjithshme ky është parakushti për një ekonomi të fortë. Një mekanik nga Prizreni thotë “ Askush nuk paguan tatime”. Shpesh, është thënë nga popullata, në përgjithësi, se njerëzit duhet të paguajnë tatimet dhe të respektojnë ligjet. Një mësues nga Vitia/Vitina thotë “Unë mendoj se Kosova nuk duhet të bëhet parajsë e tatimeve, siç është e quajtur tani. Unë mendoj se njerëzit duhet të paguajnë më shumë tatime dhe të respektojnë ligjet. Unë mendoj se njerëzit duhet të paguajnë obligimet e tyre në mënyrë qetë ketë një ekonomi të fortë.” Një grua nga Prishtina/a thotë, “Duhet të aplikohet një politikë tatimore gjithëpërfshirëse, siç janë tatimet në shëndetësi”.

Me rastin e përmendjes së TVSH, me konsensus u shtrua çështja e rishqyrtimit të saj, për shkak se u arrit deri te konkluzioni se konsumatorët nuk duhet te jngarkuar me tatime. Një grua nga Vitia thotë “është shumë herët për këtë, për arsye se çmimet janë ngritur dhe kjo nuk është e drejtë.”

---

## **Të dhëna mbi politikën ekonomike dhe financiare**

---

- Vjelja e të ardhurave të mundshme (500 milion DM) për buxhetin e Kosovës të vitit 2001 duhet të realizohet nga: 61% tatime, 32% grante të donatorëve dhe 7% tarifat (Autoriteti Qendror Fiskal, 20 Qershor 2001)
- Tatimet e vlerësuara sipas llojeve (rreth 303.9 milionë DM ) janë: 29% nga TVSH, 27% nga taksa mbi aktivitetin tregtar, 17% nga taksa mbi shitjet, 15% nga doganat, 9% nga taksa e paragjykuar, 2% nga taksa mbi pronën, 1% nga taksa mbi hotelet (AQF, 20 qershor 2001)
- Sektorët energjitikë, të furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave po ballafaqohen me vite të tëra neglizhimi, e njejta gjë po ndodh edhe me investimet në infrastrukturat fizike dhe në kapitalin njerëzor. Pjesa më e rëndësishme e këtij sistemi po i afrohet fundit të afatit të tij të përdorimit. Struktura institucionale nuk është në gjendje të kryejë funksionet e mbikëqyrjes, menaxhimit dhe financimit të këtyre shërbimeve. (Departamenti i Rindërtimit pranë UNMIK)



## QEVERISJA E MIRË, TË DREJTAT E NJERIUT DHE MUNDËSITË E BARABARTA

*“Vetëm nëse kemi qeverisje të mirë mund të sigurojmë trajtimin e barabartë të çdo personi, sjelljen e mirë dhe të drejtë të shtetit ndaj çdo qytetari dhe të garantojmë të drejtat e njeriut”*

Student nga Gjakova/Djakovica

Qeverisja e mirë, respektimi i të drejtave të njeriut, mundësitë e barabarta, mund të sjellin një paqe të qëndrueshme në Kosovë. Kjo kompetencë radhitet në vend të gjashtë për nga rëndësia nga popullata e Kosovës. Është e njohur se këto koncepte janë baza institucionale për pjesëmarrjen në jetë publike dhe në politikë, në mënyrë që të sigurohet implementimi i parimeve demokratike dhe i standardeve të të drejtave të njeriut. Sipas një gruaje nga Leposaviçi/Leposavic “Qeverisja e mirë mund të jetë çelësi i shumë problemeve shoqërore, ekonomike dhe politike.”

Mendimi i përbashkët që ka përshkruar të gjitha mbledhjet me komunitetet ka qenë se qeverisja e mirë do të sillte në mënyrë të pashmangshme të drejtat dhe mundësitë e barabarta të njeriut. Vetëm qeverisja e mirë është parakusht i të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta. Një grua nga Podujeva/a thotë “konceptet janë të ndërlidhuara...nëse kemi qeverisje të mirë, atëherë ne do të kemi të drejta dhe mundësi të barabarta pa asnjë diskriminim”

### **Të drejtat e njeriut**

Ngjajshëm me pikëpamjet e shprehura në kapitullin e të drejtave të komuniteteve, komunitetet jo-shqiptare këtë kompetencë të shoqërisë e shohin si një fushë në të cilën duhet të përfshihet edhe e drejta e lëvizjes së lirë.

Një aktor nga Shtërpca/Strpce thotë “Serbët nuk kanë të drejta. S’ka respekt për të drejtat elementare të serbëve. Mungon e drejta për lëvizje, dhe e drejta e jonë për pronë është shkelur.” Të drejtat e barabarta për minoritetet kumtohen nga të gjitha etnitë e pranishme në Kosovë. Një burrë rom nga Istogu mendon se “Të gjitha komunitetet duhet të kenë të drejta dhe përgjegjësi të barabarta para ligjit” Një e re nga Vushtrria/Vucitern beson se “qeverisja e mirë duhet të jetë një qeverisje e barabartë, të ofrojë më shumë të drejta për pakicat dhe të bëjë të mundur lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet”

## Mundësitë e barabarta për punë dhe arsim

Shkelja e së drejtës së lëvizjes, natyrisht se shkon paralel me mundësinë e barabartë për arsimim dhe punë për etnitë jo-Shqiptare në Kosovë. Njerëzit nuk gëzojnë mundësitë e barabarta elementare, si për shembull të drejtën për punësim. “Kjo ndodh për shkak të mos ekzistimit të së drejtës për lëvizje” (Serb i zhvendosur i Kosovës, në Plementina)

Shpesh është diskutuar edhe mungesa e meritokracisë brenda shoqërisë, dhe mungesa e mundësive të barabarta. Një grua e papunë nga Gjakova/Djakovica informon: “Qeverisja e mirë duhet të përfaqësojë të gjitha segmentet e shoqërisë, mirëpo kjo gjë s’po ndodh këtu, për shkak se ka njerëz të cilëve u ofrohen më shumë mundësi se sa të tjerëve”

Në mbledhjet e komuniteteve kjo temë u trajtua paralelisht me temën e pabarazisë ndaj grave. Gratë shpesh kanë shfrytëzuar rastin për të diskutuar mungesën e përfaqësimit të saj në procesin demokratik. “Gratë duhet të kenë të drejta në të gjitha sferat” thotë një nënë e re nga Malisheva. Nuk qe befasi as konsensusi i përgjithshëm se përfaqësimi grave në proceset vendimmarrëse, si në qeverisjen lokale, si në atë qendrore duhet të jetë i një niveli më të lartë. Gratë besojnë se shumë çështje me të cilat merren autoritetet qeveritare, veçanërisht të drejtat e njeriut, do të ishin shumë më të thjeshta për t’u diskutuar në qoftë se gruas do ti jepej më tepër fuqi. Përderisa autoritetet nuk marrin parasysh ingranimin e gruas si faktor shoqëror, shumica e tyre, në veçanti ato të vendeve rurale do të ndjejnë se nuk janë të përfaqësuara në nivelin e duhur. Një mësuese nga Gllogovci mendonte se “respektimi për të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta mund të arrihen vetëm me anë të përfshirjes së grave në të gjitha sferat e jetës. Duke i dhënë më shumë hapësirë përfshirjes së gruas, respektimi për të drejtat e njeriut do të arrihet dhe do të përhapet, për shkak se gratë shërbejnë si zinxhir i trasmetimit të vlerave.”

Përsa i përket mundësive të barabarta, gratë në mënyrë të qartë tregojnë se nuk dëshirojnë vetëm të jenë të përfaqësuara, por edhe të jenë në gjendje të përfaqësojnë. Një punëtor shoqëror nga Gllogovci thotë se “është e rrezikshme të përjashtohen gratë, nëse ato përjashtohen nga qeverisja, atëherë demokratizimi i shoqërisë së Kosovës nuk do të mund të arrihet” Mungesa e respektit për të drejtat e grave ishte tema kryesore në shumë diskutime që për temë patën të drejtat e barabarta gjinore përbrenda sferës së qeverisjes së mirë.

## Përgjegjësia e zyrtarëve

Ekziston një pikëpamje e veçantë se autoritetet qeverisëse duhet të tregojnë më tepër përgjegjësi ndaj individëve, jo vetëm kur kanë të bëjnë me vendimet politike dhe buxhetore, mirëpo edhe në lidhje me punësimin e kuadrove në institucione. Rritja e transparencës së qeverisjes do të shtynte popullatën të kishte një respekt më të madh ndaj organeve qeverisëse.

“Si rrjedhojë e mungesës së praktikave transparente të punës në komunat apo nivelet qendrore, qytetarët ngurrojnë gjithnjë e më shumë të paguajnë tatimet dhe kështu kufizohet mundësia e krijimit të një shteti demokratik në Kosovë.” (një inxhinier nga Deçani/i). Në një mbledhje në Gjakovë/Djakovica pjesëmarrësit janë shprehur fuqimisht se duhet përforcuar kontrolli financiar ndaj kompanive shtetërore dhe autoriteteve komunale. Ata rekomandojnë se procedura e ankesave nëpërmjet gjyqit duhet të veprojë sapo të shfaqen parregullsitë.

Shpesh del në pah fakti se politikanët nuk e kanë dëgjuar zërin e individëve prej të cilëve janë zgjedhur, gjë që shpie në një nënçmim të popullatës, kështu mendon edhe një nënë nga Vitia kur shprehet: "zëri i popullit duhet dëgjuar, sepse njerëzit janë ata të cilët i kanë zgjedhur ata që qeverisin" Në përgjithësi njerëzit janë të shqetësuar për vetë faktin se përvoja e keqe nga e kaluara mund të vazhdojë. Njerëzit e të gjitha komuniteteve kërkojnë një qeveri efektive, më pak burokratike dhe me kuadro profesionale në pozita që janë fituar me meritë. Një i papunë nga Leposaviqi/Leposavic thotë: "qeveria e mëparshme ka qenë shumë e centralizuar, jobashkëkohore dhe më pak efikase" Një student nga Malisheva/o është i të njejtin mendim dhe shton se ekziston "nevoja për një qeveri më efikase, më pak burokratike dhe jo të korruptuar." Një tjetër student nga Gjakova/Djakovica vëren se "ka shumë persona të pakualifikuar që mbajnë pozita administrative," Një teknik i ri nga Malisheva/o shpreson se "institucionet e ligjshme, si dhe njerëzit e duhur në vendet e duhura do të rezultojnë në një Kosovë të integruar demokratike.

### **Roli i shoqërisë civile**

"Çdo qeveri efikase bashkëpunon me organet e shoqërisë civile," thotë pronari i një shitoreje nga Podujeva. Sipas opinionit të të gjithë komunitetit "qeverisja e mirë" duhet të përfshijë dhe të theksojë bashkëpunimin me shoqërinë civile si psh. OJQ-të. Autoritetet duhet të bashkëpunojnë me cilindo faktor shoqëror që ndodhet brenda kuadrit të ligjit, pavarësisht nga natyra e tij; në të vërtetë është fakt i njohur se bashkëpunimi me elementët e shoqërisë civile lehtëson pjesëmarrjen e qytetarit në qeverisje, duke e bërë më efikase këtë të fundit. Sipas një gruaje të papunë nga Leposaviqi/Leposavic "njerëzit e thjeshtë duhet të kenë pjesën e tyre në strukturat themelore administrative." Ajo gjithashtu kërkon që individët të marrin pjesë, si të tillë apo në grupe, në procesin e demokratizimit"

---

## **Fakte lidhur me qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta**

---

- Në Kosovë ekzistojnë më tepër se 1.000 OJQ ndërkombëtare dhe lokale të regjistruara brenda më pak se 2 vjetësh. Aktivitetet e tyre përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin demokratik, mirëqenien shoqërore, zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit. Më shumë se 300 OJQ janë regjistruar si aktivitete për mirëqenie publike, gjë që i liron ato nga taksat dhe detyrimet doganore. Megjithatë disa prej tyre e kanë humbur këtë status të privilegjuar duke qenë se nuk përmbushin disa nga kriteret në fuqi.
- Organizatat e shoqërisë civile kanë një rol vital për sa i përket shmangjes së izolimit të komuniteteve të ndryshme nga aktiviteti i institucioneve qendrore dhe lokale.

## RINIA DHE SPORTI

*“Një vend me një numër kaq të madh të rinjsh duhet ta marrë me seriozitet përgjegjësinë që i takon ndaj tyre.”*

Student nga Kamenica

E ardhmja e të rinjve në Kosovë është në qendër të vëmendjes së shumë shqetësime, gjë që del e qartë në takimet e shumta të komuniteteve. Dihet që Kosova ka një përqindje të lartë të rinjsh në krahasim me vende të tjera të rajonit.<sup>4</sup>

Mendimi për të ardhmen e rinisë të Kosovës përmban në vetvete shumë shqetësime. Të rinjtë sapo gjejnë rastin ankohen se “s’dimë çka me ba” “jina mërzitë.” Por nga ana tjetër të rinjtë dëshirojnë të marrin pjesë në ndërtimin e Ardhmërisë së Kosovës; ata duan që zëri i tyre të ndihet. Kapitulli i mëposhtëm përmbledh shqetësimet e rinisë të cilat u shprehën gjatë takimeve të komuniteteve. Shpeshherë diskutimet u përqëndruan në çështjen e rinisë dhe të sportit, duke qenë se këto dy përgjegjësi të vetëqeverisjes së përkohshme janë binjakëzuar në Kornizën Kushtetuese.

### Zëri i të rinjve

“Rinisë duhet t’i jepen më tepër mundësi,” thotë një student në Štrpce/ Shtërpçë duke folur në emër të të gjithëve. Është e vërtetë se të rinjtë ndihen të lënë pas dore nga autoritetet dhe kërkojnë prej tyre “të investojnë në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me rininë, në mënyrë që rinia të jetë e përgatitur dhe profesionale. (student nga Kamenica/a). “Çdo qytet duhet të ketë hapësirën e tij për rininë. Zyrtarët e zgjedhur duhet të këshillohen më tepër me ne. Tashmë ne jemi thjesht në pritje pasive të vendimeve të tyre,” kritikon një grup të rinjsh nga Skenderaj/Srbica.

Të rinjtë dhe të moshuarit janë mjaft të shqetësuar për shkak të rritjes së nivelit të kriminalitetit mes të rinjve, si pasojë e mungesës së mundësive të punësimit si edhe për shkak të braktisjes masive të shkollave apo të mospërfshirjes në aktivitetet shkollore. Ata i bëjnë thirrje qeverisë “të krijojë programe për rininë për të mos e lënë atë të bie pre e krimin” (një i ri nga Gjilani/Gnjilane) Duke qenë se “fatkeqësisht shumë të rinj detyrohen ta braktisin arsimin për të mbajtur familjet” (një i ri nga Kamenica/a), një grup të rinjsh nga Bishtazhina (pranë Gjakovës/Djakovica) propozon: “rinia duhet të trajtohet mirë, të përpiqet

---

<sup>4</sup> Të rinjtë 15-25 vjeç përbëjnë 25 të popullatës totale. 50% e kosovarëve janë më pak se 22 vjeç. (Departamenti i Rinisë dhe Sporteve UNMIK/IAS)

të studiojë dhe jo të shesë cigare në rrugë. Nëse të rinjtë arsimohen, ata kanë mundësi më të mëdha punësimi, për këtë arsye shkollat duhet të përmirësohen.” Paratë dhe përpjekjet nuk shkojnë aty ku duhet” siç mendon një mësues nga Kamenica/a, i cili akuzon se “janë bërë më tepër investime në sport sesa në arsim.” Ndërsa një student nga fshati i Txhevcit pranë Kamenicës/a thotë se “sistemi arsimor ka nevojë të madhe për investim.”

Por të rinjtë duan më tepër se sa të jenë thjesht të zënë me punë për të mos shkaktuar trazira. “Kemi nevojë për aktivitete të cilat do të na e bënin të mundur të kuptojmë çështjet e gjera kulturore” shprehen të rinjtë romë dhe ashkalinj në Rahovec/Orahovac.

Gjendja e rinisë në të gjithë Kosovën nuk është ideale, por ajo duket të jetë e mjerueshme në zonat rurale. “Nuk ka asgjë për të bërë, të rinjtë po braktisin fshatrat.” (punëtor i ri nga Gjilani/Gnjilane) “Qeveria duhet të investojë për aktivitetet rinore në fshatra për ti mbajtur të rinjtë atje.”

### **Rinia dhe sporti**

“Një rini e fortë dhe e shëndetshme është e ardhmja e Kosovës” thotë një i ri nga Skenderaj/Srbica. Të gjithë janë kanë bindjen se sporti ka ndikim të mirë te rinia. Një nënë nga Obiliqi/Obilić kërkon “promovimin e të gjithave aktiviteteve sportive; ato do ti ndihmonin njerëzit t’i shmangen diskriminimit.” Një grua tjetër në të njëjtin takim vëren se “me anë të sportit të rinjtë mësojnë konceptin fair play i cili do ti drejtojë ata gjatë gjithë jetës.”

Një student nga Pogradja pranë Gjilanit/Gnijlane është i bindur se “nëse të rinjtë kanë mundësi të merren me sport ata nuk përdorin dhe nuk shesin drogat, nuk marrin pjesë në aktivitetet kriminale.” Një grup të rinjsh në Fushë Kosovë/Kosovo Polje është i bindur se “nëse do të zhvillojmë më tepër aktivitete sportive, të rinjtë do të shpëtonin nga rruga. si rrjedhojë e kësaj sporti do të ishte më i shëndetshëm.”

Vihet re një mungesë e theksuar hapësire për të rinjtë dhe fëmijët. “Gjatë pushimeve të verës shumë të rinj nuk kanë nga të shkojnë dhe e kanë të ndaluar përdorimin e fushave sportive të shkollave.” (një i ri nga Fushë Kosova/Kosovo Polje) “Tani që shkollat janë mbyllur e vetmja gjë që mund të bëjmë është të sorollatemi rrugëve. Kemi nevojë për parqe dhe më shumë aktivitete sportive” ishte shqetësimi i përbashkët i të rinjve në një takim në Skenderaj/Srbica.

Të rinjtë nga e gjithë Kosova dëshirojnë që qeveria të investojë në sport, për arsye se “ata kanë nevojë për aktivitete sportive e jo për kafiteri”- thotë një student nga Novo Bërda/ Novo Brdo.

### **Enklavat**

Problemeve të zonave rurale u shtohen edhe ato të të rinjve të enklavave të cilët e ndjejnë thellësisht pamundësinë e lëvizjes së lirë. “Çfarë mund të bëjë një i ri në një enklavë?” është pyetja e dëshpëruar e një serbi të ri nga Slivova e Kosovës (Komuna e Gjilanit/Gnjilane). “Jemi 200 të rinj e nuk kemi një fushë sporti apo një palestër” (të rinj serbë nga Donja Bornica Prishtinë/Priština). “Do të ishte me vend nëse të rinjtë e enklavave do të përfshiheshin në aktivitete sportive, sepse duke u shoqëruar me të tjerët njeriu mund të harrojë realitetin” propozojnë disa studentë nga Kusce (Gjilan/Gnjilane).

---

## Të dhëna mbi rininë dhe sportin

---

- Rinia e Kosovës me moshë midis 15-25 vjeç, përbën 25% të popullsisë totale të Kosovës e që përfshin numrin prej rreth 2.000.000 njerëzve. 50% e kosovarëve janë më pak se 22 vjeç. (UNMIK.JIAS Departamenti i Rinisë)
- Ekzistojnë më tepër se 150 grupe të rinisë dhe 58 qendra të rinisë, më tepër se 30 OJQ të cilat së bashku me Departamentin e Rinisë, UNDP dhe OSBE po punojnë për rininë e Kosovës. (UNMIK.JIAS Departamenti i Rinisë)
- Studentët në përgjithësi e përdorin alkoolin apo duhanin të paktën një herë gjatë jetës së tyre. Përdorimi i kanabisit në mesin e studentëve është relativisht i ulët (4.4%), në krahasim me “drogat e ligjshme” (29.7% duhan dhe 24.5% alkool) Përdorimi i rregullt i heroinës dhe i drogës “ecstasy” është 0.2%. Bie në sy përdorimi i shpeshtë i drogave farmaceutike në Kosovë, rreth 8.8% (shih Përdorimi i substancave narkotike midis të rinjve në Kosovë, Raport i WHO/UNICEF Programi i vlerësimit dhe reagimit të shpejtë Prill/Maj 2001)
- Kriminaliteti rinor në Kosovë është më i ulët se mesatarja e vendeve të Europës Perëndimore. Sipas departamentit të Mirëqënies publike të UNMIK, shkaku për rritjen e nivelit të tij është stresi post-traumatik dhe shpërbërja e familjeve si pasojë e konfliktit. Të rinjtë i druhen më pak policisë dhe sistemit gjyqësor sesa më parë, janë shtuar paratë në qarkullim dhe shoqëria ka humbur ngurtësinë e mëparshme. Për këtë arsye ekziston nevoja për programe parandaluese dhe për trajnimin e personelit social dhe arsimor. Së dyti, kur të rinjtë dalin nga burgu nuk ka periudhë prove për ta. Megjithatë ligji për drejtësinë juvenile është hartuar tashmë dhe pret të marrë formën e tij përfundimtare.

---

## Intervistë me zotin Driton Lajçi *Bashkëdrejtues i Departamentit të Rinisë JIAS*

---

### *Si është i organizuar Departamenti i Rinisë?*

Në departamentin tonë punojnë 53 kosovarë dhe 3 ndërkombëtarë. 30 nga 53 anëtarët lokalë të personelit punojnë nëpër komuna si aktivistë për rininë

### *Cilat janë fushat kryesore të veprimtarisë tuaj?*

Unë jam fanatik përse i përket mbrojtjes së konceptit të rinisë, rinia është pjesë e pandashme e shoqërisë. Që në fillim qëllimi kryesor i departamentit tonë ka qenë zhvillimi i aftësive të tij institucionale; vetëm duke pasur në zotërim instrumentet e domosdoshme për punë ne mund ta përqendrojmë aktivitetin tonë në zgjidhjen e problemeve serioze.

### *Cilat janë problemet e rinisë së Kosovës?*

Rinia dhe punësimi, rinia dhe shëndeti, qëndrimi ndaj gruas, rinia dhe krimi, integrimi shoqëror i pakicave.

### *Integrimi shoqëror i pakicave. Në ç'mënyrë?*

Gjatë javës rinore në vitin 2000 serbët e Kosovës nga Mitrovica e veriut iu bashkangjitën shqiptarëve të Kosovës nga Mitrovica e jugut në një aktivitet që

kishte si qëllim lyerjen e urës. Gjithashtu Drejtoria e Rinisë dhe Sporteve në Këshillin e Europës do të organizojë një seminar për të gjitha etnitë në tetor të këtij viti.

***A u intereson të rinjve politika?***

Pjesëmarrja e tyre është pasive. Do të doja që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të merrte në shyrzim mundësinë e përfshirjes së një kuote prej 30% të rinjsh në listën e kandidatëve. Përse jo? Përqindja e lartë e të rinjve në popullsi duhet të merret parasysh patjetër. Partitë politike duhet të tregojnë përgjegjësi më të lartë përse i përket përfshirjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

***Çfarë lloj legjislacioni do t'ju përllqente të përdorej nga qeveria e ardhshme në lidhje me rininë?***

Duhet të miratohet një ligj i cili merr parasysh çështjen e të rinjve dhe mundëson akordimin eqëndrueshëm të resurseve. Nga ana formale duhet të njihet një institucion i decentralizuar për të rinjtë, në mënyrë që të rinjtë të kenë diçka të tyre pavarësisht nga vendi ku banojnë.

***Sipas mendimit tuaj, çfarë do të jetë rinia pas 5 vjetësh?***

Besoj se pas pesë vjetësh të rinjtë e Kosovës do të kalojnë kohëra të vështira. Aktualisht shumë prej tyre po punojnë brenda strukturave të UNMIK dhe jeta e tyre është relativisht e kënaqshme. Me vazhdimin e procesit të kosovarizimit dhe largimin gradual të komunitetit ndërkombëtar gjendja ekonomike e rinisë do të ndryshojë.





## MBROJTJA E AMBIENTIT

*“Mbeturinat duhet të zhduken. Kosovën e dua të pastër.”*

Grua 28 vjeçare nga Suhareka/Suwareka

Një nga aspektet më të dukshme në shikim të parë për çdo të huaj që viziton Kosovën është sasia e mbeturinave nëpër fshatra dhe qytete, përgjatë rrugëve dhe nëpër fusha. Peisazhi tërheqës i Kosovës është i shkatërruar nga mbeturinat dhe jeta në qendrat urbane është bërë e padurueshme nga ndotja dhe pluhuri. Për këtë arsye është mjaft i çuditshëm fakti se mbrojtja e mjedisit është renditur e teta në listën e shqetësimeve të komunitetit; ajo nuk u përmend aspak në shumicën e takimeve. Sidoqoftë ata që e trajtojnë këtë çështje, përgjithësisht gratë, shprehin shqetësim të madh lidhur me të ardhmen e ambientit të Kosovës dhe shpeshherë kërkojnë zgjidhje ekstreme.

### Mbeturinat

Aspekti estetik i ndotjes së mjedisit i shqetëson njerëzit pasi “është e vetëkuptueshme se qytetet e mëdha, të vegjël, fshatrat dhe lumenjtë e Kosovës ndodhen nën peshën e mbeturinave” (21 vjeçar nga Suhareka/ Suva Reka). “Mbeturinat janë kudo. Nuk ekzistojnë vendgrumbullime mbeturinash. Edhe lumenjtë janë të ndotur.” ( një i ri nga Štrpce/Shtërpca). “Në Novo Bërdë nuk ka konteinerë dhe mbeturinat i gjenë kudo” Këto janë ankesat më të shpeshta. “Ne e duam mjedisin të pastër. Ne nuk duam të kemi rrezik infeksionesh nëpër rrugë” thotë një student 19 vjeçar nga Prishtina/Priština.

### Ndotja

Pamja e bllokut të Obiliqit e bën të qartë, që në shikim të parë, se banorët e atjeshëm kanë mjaft probleme. “Ndotja e ajrit është një problem urgjent. Jam vetëm 20 vjeç dhe kam probleme me mushkëritë. Jeta në Fushë Kosovë/ Kosovo Polje është një katastrofë e vërtetë për shkak të ndotjes,” thekson një i ri.

Jo vetëm në qytete, por edhe në zonat rurale, njerëzit po ballafaqohen me probleme shëndetësore për shkak të nivelit të lartë të ndotjes. Ujrat sipërfaqësore dhe lumenjtë e sjellin ndotjen në zonat rurale, gjë që e vështirëson shumë jetën e banorëve të tyre pasi, shpeshherë, ata nuk kanë asnjë burim tjetër uji të pijshëm dhe për ujitje, ankohen bujqit e një fshati pranë Deçanit/Dečani.

Banorët e të gjitha trevave të Kosovës ankohen për ndotjen e ujit të pijshëm, “gjë që përkeqëson shëndetin e fshatarëve” ankohet një grua në Malishevë/ Mališevo. “Nëpër fshatra nuk ka pika grumbullimi për mbeturinat, dhe ky problem duhet të zgjidhet nga komunat. Kjo shkakton ndotjen e ujit dhe sëmund-



jen e banorëve” shprehet një grup qytetarësh nga zona e Suharekës/Suva Reka

### Zgjidhjet

Ndoshta shumë nga zgjidhjet e propozuara për përmirësimin e gjendjes së rëndë mjedisore në Kosovë janë të vetëkuptueshme. Por, a është bërë diçka për ti vënë ato në jetë? Njerëzit në fshatra dhe qytete dëshirojnë më tepër konteinerë dhe sa më larg vendeve ku luajnë fëmijët (disa gra nga Obiliqi/Obilić), kërkohet mbledhja e rregullt e mbeturinave dhe vendgrumbullime të rregullta për mbeturinat, kërkohet rritja e numrit të pastruesve të rrugëve dhe pagesa më e mirë e tyre në mënyrë që ata ta kryejnë më mirë punën.

Banorët e Novo Bërdës/Novo Brdo dëshirojnë që “rezervuari i sistemit të kanalizimit të zhvendoset nga qendra e qytetit në periferi. Gypat shpeshherë bllokohen dhe askush nuk i pastron ato.”

Një grua nga Malisheva/Malisevo thotë: “Nëse rrugët riparohen dhe të asfaltohen, kjo do të ulte sasinë e pluhurit në ajër.” Por, të gjithë qytetarët duhet të marrin më shumë pjesë në çështjet e mjedisit: “Jam i shqetësuar, sepse nuk jemi duke e mbrojtur mjedisin. Me pejsazhin që ka Kosova mund të ishte si xhenet,” shprehet një mësues 55 vjeçar nga Peja/Pec. Ndryshimi në sjelljen e individit është hapi i parë për përmirësimin e gjendjes. “Ky aspekt duhet të merret seriozisht nga njerëzit,” vëren një teknik 36 vjeçar nga Gjlani/Gnjilane. “Mjedisi rreth nesh duhet të jetë i pastër, ne nuk duhet ti hedhim mbeturinat ku të mundim,” thotë një nënë 37 vjeçare nga Rahoveci/Orahovac e shqetësuar për shëndetin e fëmijës së saj.

Për vozitësen 34 vjeçare nga Rahoveci/Orahovac “mjedisi është i yni, ai duhet mbrojtur” Me të pajtohet edhe 18 vjeçari nga Gjlani/Gnjilane, i cili “dëshiron një mjedis të pastër.” “Nëse mjedisi është i shëndetshëm, edhe njerëzit janë të shëndetshëm” shpreson një këshilltar financiar 36 vjeçar nga Deçani/Decane. Por njerëzit duhet të edukohen mbi rëndësinë së mbrojtjes mjedisore dhe duhet të informohen se si ata mund të kontribuojnë për të.” (grua nga Istogu/Istok)

Megjithëse dihet se mjedisi duhet të mbrohet nga të gjithë, autoritetet mbajnë mjaft përgjegjësi përsa i përket shkallës aktuale të mbrojtjes së tij. “Qeveria duhet të marrë masa” thotë një grua 41-vjeçare nga Peja, dhe “organet kompetente duhet bërë më shumë që të dënojnë ndotësit e mjedisit,” e përmbledh çështjen një motër medicinale 27 vjeçare nga Suhareka/Suvarëka. Shpeshherë u propozuan gjërat për ata që nuk respektojnë mjedisin:

“Duhet të angazhohemi sa më shumë në mirëmbajtjen e ambientit, përndryshe do të na mbulojnë mbeturinat. Të gjithë ata që nuk kujdesen si duhet për mbeturinat meritojnë dënim” (Një punëtorë 43 vjeçare nga Prizreni).

“Ne jetojmë në mjedisin më të ndotur në Evropë. Do të dëshiroja që nga autoritetet të ndërmerren hapa seriozë që sa më parë që të jetë e mundur” shprehet një gjykatëse 48 vjeçare nga Prishtina, një ekspert në këtë fushë, ndërsa një nëpunës për mbrojtjen e ambientit nga Suhareka rekomandon “implementimin e rregulloreve për trajtimin e mbeturinave”

Një grup zonjash dhe zotërinjsh nga Zveçani/Zvecan, ndërsa diskutonin lidhur me gjendjen e ambientit në Kosovë, u shprehën se nëse situata ekonomike do të kishte qenë më e mirë, edhe popullata do ishte në gjendje më të mirë dhe do ti kushtonte vëmendje më të madhe ambientit dhe mbrojtjes së tij.

---

## Këshilla për mbrojtjen e ambientit

---

Gjendja e shëndetit dhe e ambientit në Kosovë është analizuar nga KFOR. Sipas këtyre analizave gjendja e përgjithshme e ambientit në Kosovë është alarmante. Problemet kyçe janë:

Në përgjithësi, sistemi i mbledhjes së mbeturinave ka nevojë për një përmirësim në tërë Kosovën. Si problem konsiderohet mungesa e kamionëve për bartjen e mbeturinave në disa zona, por edhe nënçmimi i rëndësisë së mbrojtjes së ambientit dhe i ndarjes së mbeturinave në popullatën e gjërë.

- Trajtimi jo-adekuat i mbeturinave të ngurta
- Vendet e paautorizuara për hedhjen e mbeturinave
- Prania e rrënojave të shkatëruara nga lufta, automjeteve të shkatëruara, frigoriferëve dhe mbeturinave të ngjashme të rënda.
- Mungesa e rregulloreve përkatëse për urbanizim, kanalizim dhe sistem të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Ndotja e ambientit e shkaktuar nga fabrikat dhe nga mbeturinat afër vendbanimeve.
- Mungesa e një sistemi të posaçëm për dekontaminimin e lokacioneve ushtarake dhe materialeve të ndryshme siç janë: bunkerët e nëndheshëm, substancat shpërthyes, materialet radioaktive
- Prodhimi i tymrave, pluhurave dhe gazrave nga industria
- Parqet dhe zonat e gjelbërta të shkatëruara, prerja e pakontrolluar e drunjve
- Përdorimi i pakontrolluar i plehërave ndotës
- Mbeturinat radioaktive



## TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE TË ANËTARËVE TË TYRE

*“Ata duhet të jenë ta barabartë me ne, sepse ata janë lindur këtu dhe duhet t’u ofrohet mundësia të jetojnë në vendlindjen e tyre.”*

Një teknik kompjuterësh nga Dragashi/Dragas

Nuk është për t’u çuditur pse në të gjitha takimet e mbajtura me etnitë joshqiptare në Kosovë çështja e të drejtave të komuniteteve dhe e anëtarëve të tyre rradhitet ndër prioritetet më të larta. Përveç kësaj, një numër i caktuar i përfaqësuesve të shumicës e shohin mbrojtjen e pakicave dhe dhënien e të drejtave të barabarta të gjitha grupeve etnike si “simbol të demokracisë”, siç shprehet një grua shqiptare nga Kosova.

Disa nga takimet e mbajtura me anëtarët e komuniteteve etnike joshqiptare në Kosovë janë zhvilluar në një atmosferë të të tensionuar, me ç’rast nëpunësit e OSBE-së nga Departamenti i Demokratizimit kanë hasur në vërejtje të shumta që i adresoheshin Bashkimit Evropian, për shkak se premtimet nuk ishin përmbushur, apo për faktin se Bashkësia Ndërkombëtare nuk kishte punuar aq sa duhet për mbrojtjen e interesave të pakicave. Megjithëkëtë, në pjesën më të madhe të kohës, pjesëmarrësit bisedonin me kënaqësi lidhur me çështjet të cilat u interesonin të gjithëve, duke u përpjekur që të gjenin zgjidhjet e mundshme. Pjesëmarrësit serbë, romë, ashkalinj dhe egjiptianë shprehnin vazhdimisht shqetësimin se komunitetet e tyre nuk ishin përfshirë sa duhet në procesin e konstituimit të Kornizës Kushtetuese.

Veçanërisht disa nga pjesëmarrësit e komunitetit serb theksonin pakënaqësinë e tyre ndaj disa politikanëve serbë të cilët, siç mendonin ata, kishin dështuar sa i përket parashtrimit të nevojave të vërteta të “njerëzve të tyre” dhe se “nuk njiheshin sa duhet me vuajtjet e njerëzve të tyre” siç shprehet një serbe nga Zveçani/Zvecan.

Duke dëgjuar pjesëmarrësit e komuniteteve joshqiptare në Kosovë, të cilët jetojnë në enklava apo në rrethana të tjera kufizuara, bëhet e qartë se pjesa më e madhe e problemeve të tyre ka të bëjë më pranimin e të drejtave për komunitetet nga ana e shqiptarëve të Kosovës. Edhe nëse ndonjëherë ndonjë individ apo ndonjë grup ka konsideruar një renditje tjetër përgjegjësish si prioritare, tema e diskutimit në thelb ndërlidhej vazhdimisht me çështjen e veçantë të të qenit minoritet. Për shembull, një grup të rinjsh serbë nga Silova e Gjilanit zgjedhën

“Rininë dhe Sportin” si prioritet, duke theksuar se “një numër më i madh i aktiviteteve sportive do t’u ndihmonte njerëzve që të harrojnë realitetin”.

### **Liria e lëvizjes**

Ndoshta aspekti më serioz dhe më shqetësues në gjendjen aktuale të një numri të madh komunitetesh etnike është kufizimi i lirisë së lëvizjes apo, eventualisht, shpërngulja nga vendbanimet e tyre, fshatrat apo enklavat. Përveç efektit psikologjik të “të jetuarit në geto” dhe të të qenit në rrezik gjatë lëvizjes, kjo ndikon thelbësisht edhe në të gjitha aspektet e tjera të jetës së këtyre komuniteteve. Siç bën të qartë rrjedhshëm një banor i Zveçanit/Zvecan: “Është e papranueshme që një grua të jetë e detyruar të transportohet në spital me automjet të blinduar për ta kontrolluar fëmijën e vet.”

Njerëzit nuk e ndiejnë veten të sigurt kur hyjnë në zonat në të cilat nuk janë pjesëtarë të shumicave. Udhëtimi nëpër Kosovë kështu bëhet një aventurë e padëshirueshme. Një shembull për një numër të madh të situatave të tilla na është dhënë nga një grua nga Zubin Potoku: “Siguria është problem prej momentit kur hyhet në fshatin shqiptar të Kabrës dhe me këtë rast ne druhami se ka qenë e mundur që diçka të jetë vendosur në rrugë, kështu që gjithmonë i kemi sytë katër” Kjo është mënyra jonë e të udhëtuarit -si njerëz me komplekse. Problemi nuk qëndron te banorët e Qabrës, por ne trembemi se dikush tjetër mund të kalojë përmes fshatit”

### **Shkollimi, gjuha dhe kultura**

Prindërit janë të shqetësuar për shkollimin e fëmijëve të tyre. Në shumë vendbanime të vogla sigurohet vetëm shkollimi fillor. Që të arrihet shkollimi i mëtejshëm, duhet kaluar nëpër ato zona të cilat nga një numër i madh njerëzish konsiderohen si të pasigurta. Për fëmijët e serbëve të Kosovës, të cilët jetojnë në enklava, alternativë do të ishte shpërngulja në komunitetet më të mëdha në veri të Kosovës apo në Serbi, por minoritetet tjera joshqiptare të Kosovës nuk e kanë një mundësi të tillë.

Çdo diskutim që ka të bëjë me shkollimin nënkupton domosdo përdorimin i gjuhës. Shumica posedon mundësinë e shkollimit në gjuhën amtare, ndërsa shumë fëmijë të tjerë nuk e gëzojnë këtë të drejtë” është një thënje mjaft e përhapur ndër prindërit joshqiptarë. Një grua nga Gllogovci/Gllogovac mendon se “të gjitha komunitetet do të duhej ta gëzonin të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre”. Liria e kufizuar e lëvizjes, si dhe përdorimi i kufizuar i gjuhës, e bëjnë pjesëmarrjen në jetën kulturore të vështirë, për të mos thënë të pamundur.

### **Shëndetësia**

Çështja e shëndetësisë është qartësisht e ndërlidhur me çështjen e lirisë së lëvizjes dhe me të drejtat e tjera elementare, siq është përdorimi i gjuhës. Në shumë enklava shërbimi mjekësor është minimal, çka vlen edhe për të gjitha fshatrat. Në rast se kanë nevojë për ndonjë kontroll të specialistit, pacientët duhet të udhëtojnë për në qytet më të mëdha. Fshatarët dhe pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare të Dragashit/Dragas e bëjnë të qartë se për një pjesëtar të një shumice etnike kjo paraqet vetëm njëfarë bezdie, ndërsa për të gjithë të tjerët as udhëtimi, as qëndrimi në qytet nuk janë të sigurtë. Në rast se ata janë të detyruar të drejtohen në spitalin e Prizrenit dhe nuk dinë të flasin shqip, kjo do ta bënte komunikimin me personelin mjekësor thuajse të pamundur. Shërbimi adekuat mjekësor dhe sigurimi i tij perceptohet si e drejtë thelbësore, mirëpo në

disa raste urgjente, sidomos sa i përket të personave të moshuar “të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë në spital apo te mjeku kurdo që kanë nevojë” thotë një banor i Zveçanit/Zvecan, kjo e drejtë mungon.

### **Njerëzit e dëbuar**

Në mesin e komuniteteve së brendshmi të dëbuar nga vendbanimet e tyre shpresat për një të ardhme më të mirë duket të jenë mjaft të pakta, veçanërisht për ata të cilët tanimë kanë bërë më shumë se dy vjet që kanë banuar në qendrat kolektive siç është Plementina (Obiliqi/Obilic). Kthimi në vendbanimet e tyre, në shtëpitë e tyre dhe rikthimi i pronave është për shumë nga ata parakusht për negociata të mëtejshme. Kthimi në shtëpitë e tyre dhe ndjenja e sigurisë është kërkesa më imediate gjë që konsiderohet si të drejtë elementare që nuk është ofruar deri më tani.

### **Çfarë pritet nga politikanët**

Njerëzit nuk presin mrekullira, por shpresojnë se politikanët, së paku do të implementojnë ligjin e shkruar. “Nuk ka nevojë për inovacione, çdo gjë është shpjeguar me përpikmëri në Kornizën Kushtetuese, por është e rëndësishme që kjo kushtetutë të implementohet” na përkujton një musliman nga Istogu/Istok. Një grua nga Leposaviqi/Leposavic flet në emër të një grupi njerëzish: “Ne kemi nevojë për një sistem ligjor transparent dhe të drejtë “

“Qeveria ka autoritet që të izolojë individët apo grupet që shkelin të drejtat elementare njerëzore të të tjerëve” (një banor i Zveçanit/Zvecan), pra “ka nevojë për një ligj më efektiv, i cili do të sillte një rregull më të mirë, gjë që do t’u mundësonte njerëzve ta gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë. Poashtu është me rëndësi që institucionet e reja të funksionojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare” (një serb nga Kamenica/a).

### **Shpresat e drejtuara kah Bashkësia Ndërkombëtare**

Edhe më tutje shpresat janë të drejtuara kah Bashkësia Ndërkombëtare që “të ndihmohet procesi i pajtimit”, apo, siç thonë serbët e Kosovës, “të promovohen të drejtat njerëzore për të gjithë” dhe “të krijohet rend dhe institucione legale që funksionojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare” (disa të dëbuar nga Plementina, Obiliq)

Bashkësia Ndërkombëtare duhet të hyjë aty ku politikanët lokalë kanë dëshuar apo ku politikanët nuk janë të gatshëm të hyjnë -në rrugën e dëshiruar nga njerëzit. “Duhet të ketë më shumë takime publike dhe më shumë diskutime të hapura me Bashkësinë Ndërkombëtare, takime në të cilat do të mundësohej ngritja e çështjeve specifike, gjë që do ti shtynte njerëzit e zgjedhur dhe përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme të punonin më shumë për të gjitha komunitetet” (një ashkali nga Fushë Kosova/Kosovo Polje). Një mësues serb nga Gjilani kërkon nga UNMIK-u që t’ detyrojë liderët shqiptarë të nisin dialogun me serbët.

### **Shpresat e drejtuara kah rinia**

Duket se njerëzit besojnë dhe shpresojnë se fëmijët e tyre do ta bëjnë atë që ata nuk kanë mundur ta realizojnë vetë. Njerëzit nga të gjitha komunitetet etnike shprehin dëshirën që të mbledhin së bashku fëmijët e të gjitha etnive, duke qenë se, përta i përket kësaj çështjeje, ndër të rinjtë hasim në paragjykimet. Planet mësimore duhet të përfshijnë programe të cilat japin një përshkrim mbi atë “se çfarë janë të tjerët” me qëllim që të promovohet mirëkuptimi midis kul-

turave të ndryshme dhe ky mirëkuptim të merret si shembull për bashkëjetesë të mirë në mes të etniteteve nga vendet e tjera” (njerëz nga Zveçani/Zvecan), duke qenë se “kuptimi më i plotë i marrëdhënieve interaktive thjeshtëson të kuptuarit e ndërsjellë të vetë komuniteteve” (grua nga Gllgovci/Glogovac).

Këto mesazhe u dhanë veçanërisht nga të rinjtë në disa nga takimet e komuniteteve. Sipas në gruajë të re nga Ferizaj/Urosevac, “të gjitha komunitetet duhet ta gëzojnë barabar të drejtën e lëvizjes dhe të shprehjes së lirë, pavarësisht nga përkatësia etnike.”

### **Dialogu**

“Shqiptarët duhet të nisin dialogun me ne!” Kjo kërkesë e një burri nga Zvecan/Zveçani shpreh, në mënyrën e vet, dëshirën për të nisur dialogun. Shpresa për pajtim është shprehur gati në të gjitha takimet me komunitetet joshqiptare. “Duhet të fillojmë të flasim me njëri tjetrin”, shprehet një grua nga Skenderaj/Srbica. Ndërsa një serb nga Vërbovci/Vrbovac(Vitina/Viti) është i bindur se “nëse arrijmë të bashkëjetojmë ne mund të arrijmë gjithçka.”

Por, “është e nevojshme të hedhim themele të reja” thotë një inxhinjer nga Zveçani/Zvecan. “Në Kosovë ka vend për të gjithë, askush nuk duhet të rrezikojë tjetrin. Nuk ka kombe të mirë apo të këqinj, vetëm njerëz të mirë dhe të këqinj. (Grua serbe nga Gjilan/Gnjilane).

### **Po shumica?**

Të drejtat e barabarta janë të rëndësishme jo vetëm për pakicat, por edhe për vetë shqiptarët. “Të drejtat e barabarta janë të rëndësishme për të gjithë. Unë dua të jem krenar që jam kosovar kur jam jashtë Kosovës,” shprehet një shqiptare e Kosovës nga Gjilani/Gnjilane. Kjo çështje është trajtuar me mjaft gjallëri gjatë takimeve me komunitetet. Një kryeplak nga Skenderaj/Srbica dëshiron që “Policia e Kosovës të trainohet më mirë dhe të hyjë edhe në enklava në mënyrë që të drejtat e garantuara për shqiptarët të vlejnjë për të gjithë.”

# KULTURA

*“Pa kulturën s’kemi asgjë.”*

I ri nga Podujeva/o

Sadoqë kultura si e tillë dhe nevoja e madhe për ruajtjen e saj u përmend në shumicën e takimeve të komuniteteve, ajo nuk u rendit midis prioriteteve më të larta të tyre.

## **Identiteti kulturor**

Midis pjesëmarrësve dalloheshin dy mënyra të ndryshme të perceptimit të fjalës “kulturë”. Shumica e barazonin këtë koncept me aktivitetet e organizuara kulturore. Por disa të tjerë e barazonin kulturën në një kuptim më të gjerë me “identitetin kulturor” i cili “duhet të njihet si i tillë nga populli ynë”, dhe shprehnin shqetësim lidhur me humbjen e karakterit të shoqërisë. Një grua nga Podujeva/Podujevo thotë se: “duhet të jemi të hapur ndaj kulturave të tjera, pa e humbur tonën,” ndërsa një grup të rinjsh nga Štrpce/Shtërpca shprehet se “kultura është diçka e thellë, në kuptimin më të gjerë të fjalës, e që përfshin gjithçka që përbën personin. Por njerëzit e sotshëm po e humbin kulturën.”

Takimi me kultura të tjera për shkëmbimin e përvojave është i dëshirueshëm për shumicën e njerëzve. Një rrobaqepëse e re dhe një infermiere 20 vjeçare nga Malisheva/Mališevo dëshirojnë që kultura lokale të jetë “më perëndimore”, ndërsa të tjerët thonë se “ndihen nën presionin e qytetërimit perëndimor, i cili është i papranueshëm për ne,” siç thotë një inxhinjer serb nga Zubin Potoku.

## **Zhvillimi kulturor – Zhvillim i kulturës**

Ndërvartësia e zhvillimit të një shoqërie dhe zhvillimi i kulturës së saj ishte njëra ndër çështjet më të diskutuara në takimet e komuniteteve. Sipas fjalëve të një frizeri të ri nga Prizreni, “kultura në Kosovë duhet të lëvizë përpara, sepse kjo është e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë”. “Në të ardhmen ne duhet të tregojmë më tepër kujdes për të” mendon një 36 vjeçar nga Podujeva/Podujevo.

Shpeshherë kultura dhe arsimit trajtohen paralelisht, duke qenë se arsimit i mirë ngrit vetëdijen kulturore të njerëzve. “Çdo person i shëndetshëm ka nevojë për kulturë” thotë një grua nga Podujeva/Podujevo.

## **Aktivitetet kulturore**

Sektori i kulturës është i pari që sakrifkohet në rast mungese mjetesh financiare në të gjitha vendet e botës. Dihet se Kosova ka probleme tepër të mëdha të cilat pamundësojnë organizimin e aktiviteteve të shpeshta kulturore në kuadër të rehabilitimit të këtij sektori. Mungesa e aktiviteteve kulturore ndihet në të



gjitha komunitetet, urbane dhe rurale. Ky problem i prek veçanërisht shumë banorët e enklavave apo vendeve të izoluar. Një i ri serb ankohet: “nuk ka asnjë lloj aktiviteti kulturor në Shtërpcë/Strpce” dhe në të vërtetë asgjë nuk të bën të mendosh se kjo do të ndryshojë.

Në një takim të komunitetit në fshatin Ponore pranë Malishevës/Malisevo niveli kulturor u përshkrua si “tepër i ulët”, për këtë arsye pjesëmarrësit e renditën nevojën për kulturë si prioritet të parë. Një amvisë 22 vjeçare shprehet: “unë personalisht e quaj kulturën shumë të rëndësishme, niveli i saj është i ulët në fshatin tonë dhe kjo më shqetëson së tepërmi.”

Çdo komunitet ka trashëguar shtëpinë e tij të kulturës nga sistemi socialist. Këto ndërtesa, shpeshherë madhështore, kanë mbetur të zbrazëta në ditët e sotme dhe pak është bërë në këto 2 vjet për ti riaktivizuar ato. Shumë njerëz dëshirojnë që këto shtëpi kulture të shndërrohen në teatro, kinema dhe salla panairesh, pra në vende ku të rinjtë do të merreshin me aktivitete të ndryshme kulturore.

### **E ardhmja**

Të rinjtë në enklava dhe në komunitetet e izoluar kërkojnë nga Departamenti i Kulturës të shfaq interesim më të madh ndaj investimit në aktivitete. Aspekti financiar i sektorit kulturor është një shqetësim i vërtetë. Njerëzit e dinë se “kultura kushton” dhe se ata që punojnë aty “kanë nevojë për paga të mjaftueshme”, siç vëren një grua e re nga Gjilani/Gnjilane.

Qeveritë e ardhshme duhet të përpiqen të gjejnë fonde edhe për mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore dhe monumenteve historike, shprehet një inxhinjer mekanik në Zubin Potok. Të rinjtë dëshirojnë të kenë më tepër biblioteka në Kosovë dhe do të dëshironin të botohej më tepër letërsi në gjuhët lokale.

Kur bëhet fjalë për aktivitete kulturore duket sikur ekziston një konflikt midis të rinjve dhe më të moshuarve. Një i ri nga Strpce/Shtërpcë ankohet se të moshuarit kanë në dorë gjithçka, ndërsa të rinjtë nuk kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre, dhe nuk kanë autonomi të mjaftueshme për organizimin e aktiviteteve kulturore për brezin e ri.

Dëshira e përgjithshme është që autoritetet të kuptojnë rëndësinë e kulturës për një “shoqëri të shëndetshme”

---

## **Të dhëna mbi kulturën**

- Galeritë e artit, grupet teatrale dhe disa aktivitete kulturore janë mbështetur nga donatorët dhe organizatat ndërkombëtare. Muzeu dhe Biblioteka Kombëtare kanë nevojë të madhe për mbështetje; monumentet kryesore të kulturës kanë nevojë për restaurim dhe institucionet artistike të Kosovës (Teatri Kombëtar, Orkestra Filarmonike e Kosovës, Ansambli Shota i Këngëve dhe Valleve si edhe Muzeu Kombëtar) ende kanë nevojë për ndihmesë bazike. (Departamenti i Rindërtimit UNMIK/JIAS)
- 65 nga bibliotekat publike u shkatërruan gjatë konfliktit dhe 70% të qendrave komunale të kulturës janë dëmtuar apo shkatërruar. (Departamenti i Rindërtimit UNMIK/JIAS)
- 3 Institute për Mbrotjen e Monumenteve (në Prishtinë/Pristina, Prizren dhe Gjakovë/Djakovica) dhe pesë arkiva (Prishtinë/Pristina, Prizren, Peje/Pec, Gjilan/Gnjilane and Mitrovica) kanë hyrë në rrjetin e ndihmës së dhënë nga Departamenti i Kulturës së UNMIK/JIAS



## PUNA DHE MIRËQENIA SOCIALE

*“Ligjet shoqërore nuk po funksionojnë, fëmijët i kemi të punësuar ndërsa vetë ne nuk kemi sigurime shoqërore.”*

Pensionist nga Gjakova/Djakovica

Përqindja e lartë e papunësisë, mungesa e mundësive të punësimit, familjet e shumta pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta do të duhej të zinin vendin e parë në takimet e komunitetit. Mirëpo këto çështje zënë një nga vendet e fundit në listën e çështjeve prioritare në takimet e komunitetit, madje ngandonjëherë nuk trajtohen fare.

### **Puna**

Për të gjithë ata që merren me çështjen e mirëqenies sociale, zgjidhja më e mirë e problemeve të shoqërisë kosovare është punësimi. “Papunësia është shqetësimi ynë më i madh. Papunësia përkeqëson të gjitha problemet shoqërore të Kosovës” thotë një i ri nga Ferizaj/Urosevac. Ndërsa një grua nga Deçani shprehet: “Programet e mirëqenies shoqërore do të mund të financohen vetëm kur njerëzit do të kenë mundësi të paguajnë taksat.”

Numri i saktë i kosovarëve pa të ardhura mund të gjendet me shumë vështirësi, në lidhje me të ka vetëm vlerësime të përafërta. Sipas mendimit të vetë banorëve të Kosovës, kjo shifër arrin nga 70% (një i ri në Ferizaj/Urosevac) në 80% (një teknik në Leposaviq/Leposavic)<sup>5</sup>. Është e vërtetë se shumë njerëz kanë humbur vendin e punës pas përfundimit të konfliktit ose për shkak të ristrukturimit të sektorit publik. Mundësitë e punësimit masiv në administratën publike apo në ish-ndërmarrjet shoqërore janë tashmë tepër të rralla, sidoqoftë ende mjaft të kërkuara.

Një grup romësh dhe hashkalinjsh nga Rahoveci/Orahovac janë të bindur se “nëse do të arrinin të rimerrnin vendet e tyre të punës, atëherë ndihmat sociale do ti merrnin ata që vërtet do të kishin nevojë për to.”

Shumë të rinj ende nuk kanë patur mundësi të gjejnë një vend pune dhe natyrisht ata “do të dëshironin të punojnë për të mbajtur vetveten, për të mos qenë të varur nga prindërit” thotë një 21 vjeçar i papunë nga Suhareka/Suva Reka. Thënia e tij pasqyron shqetësimin e shumë të tjerëve. Dhe “duke qenë se nuk ka ndihma për të papunët, shumë prej tyre jetojnë në kurriz të familjes” (një punëtor i ri në Shipol pranë Mitrovicës), gjë që rëndon financiarisht familjet dhe

---

<sup>5</sup> Realiteti nuk është aq dramatik, por ende shumë i keq, pasi që mesatarisht 50% e popullsisë është e papunë, bazuar në Departamentin për Punë dhe Punësim në UNMIK/JIAS

poshtëron të rinjtë. Një student në Skenderaj/Srbica shpreh frikën e brezit të ri nga e ardhmja e pasigurtë duke thënë: "Nëse një i moshuar është i papunë, ai mund të mbështetet tek fëmijët e vet, por nëse një i ri nuk ka punë, ai nuk ka mundësi të plakët."

Përballë mungesës së përgjithshme të punës dhe mundësisë për të patur të ardhura të mira, anëtarët e bashkësive joshqiptare të Kosovës ndihen të braktisur. "Kur paraqitemi për një vend pune, ne dorëzojmë dokumentat tona të cilat nuk merren parasysh, ne jemi të diskriminuar." (një rom nga Kamenica/a). Një serb 26 vjeç nga Kosova thotë se "shumica e serbëve janë të papunë, fabrikat janë mono-etnike, gjë e papërsëritshme kudo në botë. Njerëzit duhet të punësohen në bazë të aftësive të tyre, dhe jo mbi baza etnike." "Detyrojini drejtorët shqiptarë të fabrikave të punësojnë edhe jo-shqiptarët," kërkojnë romët dhe serbët e Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.

### **Pensionet**

Çdo brez ballafaqohet me një gjendje të veçantë. Ndërsa të rinjtë nuk arrijnë të gjejnë punë, brezi më i vjetër ka punuar një jetë të tërë por nuk mund të gëzojë frytet e punës së tij. Kontributet e paguara në skemën sociale jugosllave me dekada të tëra nuk po kthehen sot në formën e pensioneve. Një pensionist në Pejë kërkon që qeveria të ushtrojë presion ndaj Jugosllavisë, duke qenë se kontributet janë paguar me vite të tëra." "Nuk kemi marrë pensionet tona për tre vitet e shkuara, po shkelet një e drejtë e cila është e garantuar në Konventën e OKBsë", thotë një burrë i moshuar në Gjakovë/Djakovica.

### **Rastet e rënda sociale**

Si pasojë e konfliktit, shumë gra kanë mbetur vejusha dhe mbajnë përsipër të vetme përgjegjësinë për të gjithë familjen e cila përbëhet nga fëmijët dhe prindërit e moshuar.

Nuk ekzistojnë ndihma për gratë e veja. Të ardhurat e prindërve shpeshherë nuk mjaftojnë për të mbajtur familjen. Dhe kështu ndodh që fëmijët detyrohen të marrin rrugët për të shitur cigare dhe artikuj të tjerë. Ky fakt, së bashku me daljen e fëmijëve nga sistemi i rregullt i shkollimit dhe i punësimit të ardhshëm përbën një nga shqetësimet më të mëdha të shoqërisë. Për të shmangur dhe përballuar këtë degradim duhet t'u kushtohet më tepër vëmendje familjeve të varfra, thotë një mësues i papunë nga Gjilani/Gnjilane.

Një tjetër grup i pambrojtur i shoqërisë janë të paaftët për punë. Një i ri nga Shipoli pranë Mitrovicës/a thotë: "Kemi nevojë për punësim dhe edukim për të paaftët për punë. Të drejtat e tyre për mirëqenie shoqërore duhet të mbrohen me anë të inkurajimit të programeve të riaftësimi si edhe me anë të ndërtimit të planeve të pjerrta të hyrjes në ndërtesa."

### **Sistemet**

Njerëzit shikojnë me kujdes kalimin nga sistemi socialist të cilin e njohën mirë, në një sistem të panjohur. Njerëzit frigohen nga masat radikale, nga racionalizimi i tepërt, nga "aplikimi i kritereve shumë rigorozë perëndimore" thotë një i papunë nga Gjilani/Gnjilane. Siq thonë pensionerët në takimin në Prishtinë/Pristina, më parë do ta mirëmbanin sistemin aktual i cili ju siguron nga 10 DM pensionë në muaj. Për njerëzit e gjitha etniciteteve përgjegjja e vetme ndaj papunësisë së madhe është "sistemi i vjetër", duke menduar në riaktivizimin e fabrikave shtetërore dhe "ri-punësimin e të gjithëve si më parë, në administratën

publike”<sup>6</sup>. Që nga “mbyllja e shumicës së fabrikave mirëqenia shoqërore e pensionerëve, invalidëve, fëmijëve dhe personave të hendikepuar është keqësuar”.

### **Çfarë mund të bëjmë?**

“Skemat e mirëqenies sociale janë në gjendje katastrofike!” Padyshim gruaja kosovaro-serbe nga Kamenica nuk është e vetmja që ka këtë opinion. Por cilat mund të jenë zgjidhjet? Çështja i ka kaluar qeverisë. Njerëzit presin që qeveria të merret me të. “Përpara se të zgjidhim problemet e përditshme të pensionistëve na duhet sëpari të dalim nga kriza politike dhe financiare.” (Një 42 vjeçar nga Gjilani/Gnjilane). Qeveria e ardhshme duhet të gjejë donacionet, thotë një grua nga Deçani.

Një i ri nga Gjakova/Djakovica është i mendimit se duhet të mblidhen statistika të sakta në lidhje me gjendjen shoqërore të banorëve të Kosovës. Në këtë mënyrë qeveria do të mund të shpërndante ndihmën sociale në mënyrë më të drejtë. Jeta e përditshme e njerëzve nuk njihet mirë midis vendimmarrësve, është mendimi i një gruaje në Gjilan/Gnjilane. “kemi punonjës të entit social të cilët nuk kryejnë punën e tyre ashtu siç duhet. Ata nuk e kuptojnë realitetin dhe shpeshherë marrin vendime të gabuara.”

Një drejtor shkolle nga Kamenica vëren se “të gjitha problemet e mirëqenies sociale janë të lidhura ngushtësisht me zhvillimin ekonomik dhe punësimin, për këtë arsye këto probleme duhet të merren më tepër parasysh nga sindikatat. Por vetë sindikatat janë të paralizuara duke qenë se dhjetëra mijëra punëtorë janë pushuar nga puna.” Një tjetër punëtor miraton: “Duhet ti japim më tepër rëndësi rolit të sindikatave.”

Ky rreth vicioz përshkruhet edhe më mirë nga një burrë nga Rahoveci: “mungesa e punësimit shkakton mungesën e edukatës së punës në brezat e ardhshëm, gjë që ul mundësitë e punësimit dhe krijon vartësi kronike nga ndihmat humanitare apo sociale.”

Zhënjimi është një ndjenjë mjaft e përhapur. “Politikanët na kanë premtuar ndihmë sociale dhe pensione, por asgjë nuk është plotësuar. Të hyrat e Kosovës janë tepër të ulëta për pagesën e rrogave dhe pensioneve njëkohësisht. Pagat janë tepër të ulëta. Pagesat e rrymës janë trefishuar në krahasim me periudhën e paraluftës. Shërbimet publike janë tepër të shtrenjta. “Mendimet e njerëzve duhet të dëgjohen më shumë, përndryshe është e kotë të votojmë për çfarëdo parti politike.”(një grua nga Gjakova/Djakovica)

Vetëm disa nga pjesëmarrësit e rinj në takimet e komunitetit e morën në konsideratë çështjen sociale, megjithatë një i ri nga Deçani thotë: “duhet të jemi më kreativë për arritjen e asaj që synojmë, dhe duhet të punojmë së bashku”, ndërsa një 23 vjeçar nga Lipjani thotë: “kemi dalë nga konflikti të shkatërruar ekonomikisht dhe financiarisht. Kemi nevojë të madhe për ndihmë për njerëzit pa shtëpi dhe jetimët. Shoqëria jonë mban përgjegjësi të madhe për këto kategori.”

---

<sup>6</sup> shih Kapitullin për Politik Ekonomike dhe Financiare

---

## Fakte mbi Punësimin dhe mirëqenien sociale

---

- Papunësia e vlerësuar në Kosovë është rreth 50%, (43% në zonat urbane dhe 57% në zonat rurale). Papunësia e grave arrin në rreth 53%. Të punësuarit janë rreth 33%. Një rrjet punësimi me 29 përfaqësi në Kosovë ndërmjetëson gjetjen e vendeve të punës. Departamenti i Punësimit po punon në një skemë të ngjashme edhe për minoritetet. (UNMIK/JIAS Departamenti i Punësimit).
- 6 qendra të ndërmjetësimit për punësim po funksionojnë në qytetet e mëdha, duke dhënë referenca për punësim, trainim dhe vlerësim të nevojave të tregut.
- 55.000 familje përfitojnë nga skema e asistencës sociale të UNMIK e cila u mundëson ndihmë financiare familjeve më të varfëra të Kosovës. (UNMIK/JIAS Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale).
- Afërsisht 10.000 deri në 12.000 familje ndodhen ende në listat e ndihmës për rindërtim. (UNMIK/JIAS Departamenti për Rindërtim).
- Pensionet nuk u paguhen 97.000 personave që kanë të drejtën e pagesës së pensioneve dhe pagesave për invaliditetin. Nuk ekziston sistem pagese për raste sëmundjesh, paaftësie për punë apo papunësie.
- Gjatë vitit 2001, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale së bashku me Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë do të implementojnë një sistem më të sofistikuar afatgjatë të mirëqenjes sociale i cili në të ardhmen do të jetë në gjendje të mbështesë qytetarët e Kosovës. (Buxheti i konsoliduar i Kosovës 2001)



## TREGTIA E BRENDSHME DHE E JASHTME, INDUSTRIA DHE INVESTIMET

*“Ne kemi nevojë për punë, nuk na duhet mëshira e askujt.”*

Bujk 58 vjeçar nga Skenderaj/Srbica

Kushtet e vështira të industrisë (“kemi shumë fabrika të cilat nuk prodhojnë Kasgjë”) dhe mungesa e produkteve të brendshme të Kosovës janë shqetësimet më të shprehura në mbledhjet e komuniteteve në të gjithë Kosovën. Teknologjia e vjetër dhe mungesa e ligjeve të përshtatshme për të mbrojtur sigurinë e investimit në Kosovë konsiderohen si shkaktarët kryesorë të vështirësive të tanishme. Natyrisht shumë prej pjesëmarrësve në mbledhjet e komunitetit nuk kanë informacione të mjaftueshme në lidhje me botën komplekse të tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve në industri. Njerëzit në përgjithësi mbështeten ende në përvojat e vjetra të cilat ata i konceptojnë si logjikë të shëndoshë. Për këtë arsye importi nga jashtë shpjegohet shpeshherë me anë të mungesës së prodhimit në vend “i blejmë mallrat jashtë, por në të vërtetë mund ti prodhojmë në vend”. Popullsia e dëshiron nisjen e prodhimit në vend sa më shpejt të jetë e mundur për të shmangur vartësinë nga jashtë. “Nëse fushat kultivohen ashtu siç duhet, edhe rendimenti do të rritet” është mendimi i një bujku të vjetër nga Skenderaj.

Fuqizimi i tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme, ashtu si edhe zhvillimi i industrisë duhet të konsiderohet si prioriteti numër një i qeverisë së ardhshme, gjë që duhet tu transmetohet edhe mbledhjeve të ardhshme të komuniteteve.

### **Investimet**

Një grua në Kaçanik vëren: “nëse ne arrijmë të zhvillojmë industrinë tonë, atëherë do të ekzistojë mundësia të kemi tregti të brendshme dhe të jashtme dhe do të mund të krijojmë kushtet për të tërhequr kapitalin nga jashtë nga i cili do të varet e ardhmja e Kosovës.”

Këto investime do të krijojnë mundësi më të mira për punë dhe infrastrukturë më adekuate. Mendimi i një grupi të rinjsh nga Kamenica është se “krijimi i një Kosove me liri të lëvizjes së lirë për të gjitha komunitetet në përputhje me konventat ndërkombëtare do t’i lehtësonte investimet nga jashtë”. Një grua nga Deçani/i është e bindur se nuk do të ketë progres pa investimin e huaj në Kosovë “investimet stimulojnë zhvillimin industrial i cili përcakton edhe zhvillimin e

tregtisë së brendshme”. Apo: “investimet e jashtme dhe të brendshme në industri janë sfida të rëndësishme për kandidatët e zgjedhur të cilët duhet të sjellin qetësinë dhe rendin e nevojshëm për investuesit,” thotë një burrë nga Ferizaj/Urosevac. Zëri i njerëzve i shtyn liderët e ardhshëm të Kosovës të shqyrtojnë mënyrat e tërheqjes së investuesve për rritjen e mirëqenies në Kosovë.

### **Ristrukturimi**

Një inxhinier nga Suhareka mendon se restrukturimi i industrisë është tepër i rëndësishëm sepse “pa përparimin e tregtisë dhe industrisë nuk do të kemi përparim të Kosovës”. Të gjitha industritë të cilat tani për tani janë nën pronësi shoqërore duhet të privatizohen: “investimet duhet të përdoren për rritjen e kapacitetit prodhues, dhe të punësimit në Kosovë.” Një i ri nga Lipjani/Lipljane sugjeron që të nisët sa më shpejt tregtia me Europën dhe Ballkanin. “Shumica e popullsisë e siguron jetesën nga tregtia, por tregtia nuk mund të forcohet mbi baza individuale, por duke u mbështetur nga autoritetet.” Për shumë njerëz, propozimi kryesor për qeverinë është dhënia e mundësive për punësim veçanërisht për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale.

---

## **Fakte në lidhje me tregtinë e brendshme dhe të jashtme, investimet dhe industrinë**

---

Sipas Përmbledhjes Statistikore të Arkivit të Biznesit nga IOM, në prill të 2001

- Numri total i bizneseve përbëhet nga një përqindje e njëjtë e ndërmarrjeve shoqërore dhe shtetërore (49.6%) dhe ndërmarrjeve private (50.4%). Ndërmarrjet e vogla (0 deri në 4 të punësuar) përbëjnë pjesën më të madhe të bizneseve (77.4%)
- Komunitat jugperëndimore të Kosovës kanë përqindjen më të lartë të punësimit, me përjashtim të Deçanit. Përqëndrimi më i madh i bizneseve dhe i punësimit vihet re në Prishtinë.
- Në krahasim me numrin total të popullsisë, rajonet e Pejës dhe Gjakovës përfshijnë nivelin më të lartë të aktiviteteve të biznesit dhe vetë-punësimit, respektivisht 13% në Pejë dhe 11% në Gjakovë të krahasuara me 8% të Prishtinës, Deçanit, Istogut dhe Podujevës.

# MBAJTJA E MARRËDHËNIEVE ME BASHKËSINË EUROATLANTIKE

*“Integrimi me botën e jashtme do të thotë zhvillim i botës së brendshme.”*

Mësues nga Skenderaj/Srbica

Kosova e administruar nga OKB është një rajon në të cilin është i vështirë një diskutim objektiv në lidhje me marrëdhëniet e tij të ardhshme me komunitetin euroatlantik. Vihet re se në përgjithësi shumë njerëz në takimet e komunitetit e shohin veten politikisht, ekonomikisht, madje edhe në aspektin kulturor nën vartësinë e vendeve perëndimore. Pas krijimit të qeverisë qendrore në Prishtinë do të na duhen më tepër investime nga komuniteti ndërkombëtar, mendon një grua nga Peja/Pec. Ky është një mentalitet i shpjgueshëm me anë të rrethanave të tanishme. Marrëdhëniet me bashkësinë europiane nuk mund të jenë simetrike për momentin, për këtë arsye thelbi i bashkëpunimit aktual është reduktuar vetëm në ndihmesën ndërkombëtare ndaj Kosovës.

“Bashkëpunimi me vendet europiane na mundëson zhvillimin ekonomik, teknik dhe kulturor këtu në Kosovë” është i mendimit një mësues 28 vjeçar nga Podujeva/o. Një punëtor nga Skenderaj mendon se marrëdhëniet e mira me bashkësinë ndërkombëtare janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve të brendshme të Kosovës.

Përparimi i marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik konsiderohet si një kusht thelbësor për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe për arritjen e stabilitetit në Kosovë. “Mirëqenia e shoqërisë kosovare është ngushtësisht e lidhur marrëdhëniet e mira me bashkësinë europiane” (mësues në Klinë/a) Një vërejtje e tillë vjen nga një gazetar nga Klina: “Vendet e Ballkanit kanë patur gjithnjë probleme për ruajtjen e stabilitetit, pra është e mundur ta ruajmë stabilitetin në Kosovë vetëm me anë të marrëdhënieve të mira me SHBA dhe NATO-n”

## **Kuptimi i marrëdhënieve me jashtë**

“Do të më pëlqente që Kosova të integrohej në procesin ndërkombëtar. Marrëdhëniet me bashkësinë euroatlantike duhet të forcohen. Shoqëria kosovare duhet të tregojë shumë gatishmëri drejt bashkëpunimit,” thotë një punonjës nga Firaja në Shtërpcë. Kosova gjeografikisht është në Europë dhe “do të ishte e natyrshme të mbështetet ky proces.” (një burrë nga Peja/Pec) Shumë pjesëmar-

rës ishin dakord me mbajtjen e marrëdhënieve të mira “për ruajtjen e paqes në Kosovë zhvillimi ekonomik është i papërfytyrueshëm pa bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.” (avokat nga Skenderaj/Srbica)

Megjithatë njerëzit janë optimistë në lidhje me të ardhmen e Kosovës dhe nuk dyshojnë se bashkëpunimi do të jetë gjithnjë e më i ngushtë. “Duke hyrë në komunitetin euroatlantik Kosova do të zhvillohet gjithnjë e më shpejt. Njëkohësisht ligjet ndërkombëtare, rregulloret, të drejtat e njeriut dhe standartet ekonomike do të respektohen” thotë një motër medicinale nga Suhareka/Suva Reka. Pjesëmarrësit në mbledhjet e komunitetit shprehën vullnetin e tyre të mirë për përmirësimin e kushteve të jetesës në Kosovë. Një bashkëpunim më i ngushtë me faktorët e jashtëm u kërkua fuqimisht në Kaçanik përse i përket rehabilitimit të pasluftës.



## **BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL**

*“Bazat e shoqërisë krijohen duke mbajtur një bujqësi të zhvilluar.”*

Fermer nga Klina/Klina

Kosova është një rajon veçanërisht rural; për këtë arsye zhvillimi i bujqësisë duhet të merret parasysh përse i përket rritjes së standartit të jetesës për fshatarët. Bujqësia do të mund t’u ofronte të rinjve një aktivitet konkret dhe përgjegjësi më të madhe për zhvillimin e fshatrave. “Duke marrë parasysh se unë jetoj në fshat, bujqësia dhe pyjtaria janë thelbësore pasi unë nuk shoh mundësi të tjera zhvillimi për këtë zonë”, thotë një fermer nga Brodi në Dragash. Lidhur me gjendjen në Deçan një fermer thotë se “bujqësia është thelbësore veçanërisht në zonën e Isniqit, duke qenë se ajo punëson shumicën e banorëve të atjeshëm. Afërsia e tregut të Pejës është një mundësi më tepër për fermerët, por mungesa e farërave dhe e pajisjeve bujqësore i pengon ata të jenë më konkurrencialë.”

Zhvillimi rural është i nevojshëm, por ka shumë pak vende ku fshatarët mund të shesin lirisht produktet e tyre. Gjendja e sigurisë duhet të përmirësohet në mënyrë që fshatarët të mund të shkojnë dhe të shesin produktet e tyre.” (Fermer nga Gjilan/Gnijlane)

### **Zhvillimi i bujqësisë**

Një kërkesë që u është bërë shpeshherë autoriteteve të ardhshme të Kosovës është që ato duhet tu kushtojnë më tepër kujdes gjendjes në zonat rurale përse i përket ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme. Një mësues nga Suhareka/Suva Reka këshillon rritjen e investimeve në bujqësi dhe për mbrojtjen e pyjeve, “por na duhen veprime reale, jo thjesht fjalë.” Një fermer serb nga Gjilani/Gnijlane vëren se duke qenë se shumica e serbëve jetojnë në fshatra dhe po e braktisin Kosovën nga dita në ditë, duhet të krijohen kushtet për ti ndihmuar ata serbë që kanë mbetur të rrinë edhe më, dhe që të kthehen serbët e ikur. Në bujqësi njerëzit kanë mundësi të propozojnë projekte reale të cilat janë në gjendje ti realizojnë vetë.

Një mësues nga Podujeve/o shprehet se “zhvillimi i bujqësisë do të na mundësonte të mos të ishim të varur nga ndihmat e huaja, dhe do të kishim mundësi ti zgjidhnim vetë problemet tona.” Popullata në zonat rurale është mjaft e madhe dhe në Kosovë i kemi të gjitha rrethanat për zhvillim të shpejtë.”

### Faktorët për stabilitetin ekonomik dhe social

Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural janë “një degë e rëndësishme e industrisë dhe përbëjnë zgjidhjen e vetme për boshnjakët që jetojnë në këtë zonë të Kosovës,” thotë një i papunë nga Recane në Prizren. “Ata që jetojnë në zonat e thella rurale nuk duan të jetojnë më atje, ndaj më shumë punë duhet bërë për këto zona për ndërtimin e infrastrukturës,” thotë një përfaqësues i OJQ-ve nga Obiliqi. “Bujqësia ndihmohet në të gjithë botën, por jo këtu.” Shpeshherë fermerët propozojnë të mos paguajnë taksa në mënyrë që të mbështetet faza e parë e zhvillimit të bujqësisë. “tani për tani askush nuk na përkrah. Fermerët që posedojnë 10 apo 15 ha tokë kanë probleme për t’i ujitur. Kemi nevojë për programe për zhvillimin e bujqësisë.” (Fermer nga Klina/a) Duhet të kryhet një vlerësim adekuat i nevojave të fermerëve llojeve të kultivatëve dhe gjedhit. Ky vlerësim do të mund të përdorej nga donatorët e ardhshëm. “Në Isniq kemi patur një kooperativë por puna në të u ndal disa vite më parë. Zyrarët e rinj duhet të koordinojnë vlerësimet në mënyrë që komunat të mund të fokusohen në identifikimin e donatorëve dhe përgatitjen e projektpropozimeve.” “Populata dhe qeveria duhet të bashkëpunojnë për të garantuar kushte të mira jetese për të gjithë.” (I papunë nga Deçani) dhe bujqësia është një resurs thelbësor për arritjen e zhvillimit në zonat e varfra rurale.

---

### Fakte mbi bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin rural

---

- Produktet bujqësore
- Problemet kryesore
- % e tokës së punueshme, pylltaria
- Riaktivizimi i ekonomisë rurale ka patur zhvillime pozitive me ndihmën e konsiderueshme të donatorëve. Janë riparuar 15.000 traktorë dhe 900 makineri të tjera bujqësore, janë shpërndarë 3,000 gjedhë dhe ky sektor është ndihmuar me anë të një projekti të vaksinimit në shkallë të gjerë. 35.000t plehra kimike u janë shpërndarë 48.000 familjeve të fermerëve. (Departamenti i Rindërtimit i UNMIK)
- Në bashkëpunim me ndërmarrjet publike lokale janë kryer përmirësime të cilat do të mundësojnë ujitjen e mbi 25.000 ha tokë, gjë që do të dyfishojë të korrat.
- Në krahasim me bizneset e tjera të regjistruara në Kosovë, bujqësia, gjuetia dhe pylltaria kapin një nivel prej 1.1% kryesisht për shkak të shkallës së ulët të regjistrimit të aktiviteteve bujqësore (Enti statistikor i Kosovës)



## FAMILJA, GJINIA DHE TË MITURIT

*“Të gjitha çështjet nisin me familjen, nëse familja është e shëndetshme, ne do të kemi një shoqëri të shëndoshë.”*

Grua nga Istogu/Istok

Kompetencat e Familjes, Gjinisë dhe të Miturve diskutohen rrallë, sado që shpeshherë përfshihen brenda dhjetë prioritetëve primare të mbledhjeve të komuniteteve. Katër ishin mendimet kryesore lidhur me këtë çështje: roli i familjes në një shoqëri demokratike, roli i gruas, kushtet ekonomike të nevojshme për plotësimin e nevojave familjare dhe mundësia e edukimit të rinisë.

### **Roli i familjes në një shoqëri demokratike**

Të gjitha komunitetet etnike nënvizojnë njëzëri se njësi bazë e shoqërisë është familja. Shoqëria e cila mbështetet mbi të tilla njësi bazë është një shoqëri e qytetëruar dhe demokratike. Mënyra e funksionimit të familjes pasqyron shoqërinë në të cilën ajo bën pjesë. “një familje demokratike ndihmon në krijimin e një shoqërie demokratike” mendon një absolvent i papunë i drejtësisë nga Podujeva/o. I të njëjtit mendim është edhe një serb 38 vjeçar i shpërngulur në Brezovicë/Brezovica: “Familje e shëndoshë-shoqëri e shëndoshë”.

### **Roli i gruas në familje**

Barazia për gratë në familje është një temë e përmendur në mënyrë të veçantë nga gratë gjatë diskutimit të çështjeve të familjes, të gjinisë dhe të të miturve. Mungesa e edukimit dhe mungesa e vendimmarrjes brenda familjes janë dy çështjet të cilat u theksuan nga një grup grash në Podujevë/o. Një veprimtare 33 vjeçare e shoqërisë civile nga Podujeva/o është e mendimit se roli i grave në familje ka qenë nënvleftësuar për një kohë shumë të gjatë.

Ajo i bën apel assemblesë së re ti japë prioritet më të lartë grave në vendimmarrje dhe në të gjitha sferat e jetës. Një studente bie dakord me këtë duke theksuar problemin e dhunës në familje. Ajo thotë se fatkeqësisht shtypja e grave vazhdon edhe pas luftës. “Ka shumë raste dhune ndaj grave. Gratë qëndrojnë të mbyllura në shtëpi, nuk kanë të drejtë të shkollohen; ato nuk kanë asnjë të drejtë. Për këtë arsye i kërkoj qeverisë së zgjedhur ti ndihmojë gratë.”<sup>7</sup> Një tjetër grua e re në Podujevë mendon se gratë duhet të arsimohen më tepër në vartësi të faktit se

---

<sup>7</sup> Është vështirë të sigurohen të dhëna statistikore për rastet e dhunës, sepse dhuna ndaj gruas në përgjithësi nuk konsiderohet krim , dhe nëse ju ndodh pak gra raportojnë.

edukimi i fëmijës jepet kryesisht me anë të nënës, dhe për më tepër, një grua e edukuar i kapërcen më lehtë pengesat që i vihen nga burrat.

Shpeshherë gratë e edukuara nuk kanë mundësi të vazhdojnë karrierën e tyre pas martesës. “Në shumë raste gratë e arsimuara padrejtësisht detyrohen të lëshojnë punën” Një grua e martuar serbe e Kosovës e shpërngulur në Brezovicë/a thotë se barazia gjinore brenda familjes nënëkupton më tepër edukim për gratë.

### **Gjendja ekonomike**

Gjendja e rëndë ekonomike me të cilat duhet të përballen disa familje krijojnë tensione në raportet familjare, veçanërisht nëse gruaja është e punësuar, një gjë mjaft e vështirë për burrin duke qenë se tradicionalisht është ai që mban familjen. “Unë punoj mirëpo burri im nuk punon. Është e qartë se problemi fillon këtu. Ai është duke kërkuar punë mirëpo nuk mund të gjejë. Ndërsa unë kam tre fëmijë” thotë një grua nga Rahoveci/Orahovac. Ajo thekson se nuk është se burri i saj nuk dëshiron të punojë, ai është i aftë dhe dëshiron që të punojë, mirëpo nuk ka punë. “ Të paktën një person nga familja duhet të punësohet pa marrë parasysh nëse është gruaja apo burri” Në mbledhjen në Rahovec/Orahovac një grua shpjegoi vështirësitë e grave për tu punësuar dhe edukuar njëkohësisht, pasi përshembull burrat mund të punojnë në kafeteri për një pjesë të kohës ndërsa “gratë kultura nuk i lejon të punojnë në vende të tilla siç është e mundur jashtë Kosovës. Nëse një femër do të punonte kështu, ajo do të kishte reputacion të keq.” Shumë familje kanë nevojë për ndihmë sociale dhe autoritetet që do të zgjidhen duhet ti mbështetin ato. Një gjendje më e mirë financiare ndikon pozitivisht në marrëdhëniet financiare.

### **Të miturit**

Një familje e shëndoshë i çon fëmijët drejt një të ardhmeje të sigurtë. Pjesë-marrësit në takimet e kosovarëve joshqiptarë ishin të shqetësuar përse i përket gjendjes së vështirë të të miturve të cilëve u mungojnë kushtet e duhura për edukim, gjë që ka efekt negativ ndaj të ardhmes së tyre. Një mësues ashkali nga Rahoveci/Orahovac thotë se “të rinjve duhet tu jepet një mundësi për tu edukuar, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.” Një i ri serb nga Leposaviqi/Leposavic thotë se “të rinjtë duhet të mbrohen nga papunësia me anë të edukimit” Një çështje tjetër e theksuar nga një 45 vjeçar nga Kamenica/a është se ka shumë fëmijë pa prindër dhe se qeveria duhet të kujdeset për ta.

Një grup grash nga Shtërpce/Strpce nënvizoi disa nga problemet e komunitetit të atjeshëm. Alkoolizmi midis të miturve është në rritje, kjo përbën problemin më i madh që duhet të zgjidhet në këtë komunë.” Ato shprehën dëshirën të edukojnë më tepër rininë lidhur me problemet e alkoolizmit, drogave, SIDË-s dhe planifikimit familjar.

---

## **Fakte mbi familjen, gjininë dhe të miturit**

---

Numri i personave për familje në Kosovë është në rënie. Nga 7 anëtarë në vitet 80-90, mesatarja është 5.6 banorë për familje. Në zonat urbane mesatarja është 4,9 në zonat rurale është 6,3. (tipare bazike të popullsisë, IOM)

- Papunësia midis grave në Kosovë ka arritur 75% (nga 63% përpara luftës) Vetëm 35% e grave punonin jashtë shtetësisë përpara konfliktit, vetëm 27% e grave punojnë në aktivitete fitimprurëse. 34% kanë aktivitete biznesi dhe 23% janë pronare të bizneseve të vogla. Gratë në Kosovë nuk janë të përfaqësuara në pozita drejtuese (Gruaja 2000, Komiteti i Helsinkit, Vienë 2000)

## TRANSPORTI, POSTA, TELEKOMUNIKACIONI DHE TEKNOLOGJITË INFORMATIVE

*“Nuk kemi lidhje të rregullta me botën.”*

Grua nga Zveçani/Zvecan

Sadoqë këto çështje nuk u renditën midis prioriteteve të para, krijimi i një sistemi funksional komunikimi hyn ndër çështjet që i shqetësojnë njerëzit, veçanërisht ata që jetojnë në zona të izoluara. “Kemi telefona, por nuk ka sinjal, kemi televizorë por jo programe, kemi vetura, por na mungojnë rrugët,” është vlerësimi i një gruaje në Zubin Potok. “Linjat telefonike punojnë një ditë po dhe një ditë jo,” thotë një grua nga Zveçani/Zvecan, dhe fqinji i saj pohon “vetëm sa e dimë që ekziston interneti, por nuk mund ta përdorim. Djali ka kompjuter në shtëpi, por nuk mund të komunikojë me botën për shkak të linjave telefonike.”

Rrugët e dëmtuara dhe transporti publik i kanë shqetësuar shumë kosovarët vitin e kaluar<sup>8</sup>. Kjo gjendje është përmirësuar këtë vit. Megjithatë ka ende mjaft për të bërë, përshembull në rrugën nga Leshaku në Vraccë që i shqetëson banorët pranë Leposaviqit. Shumë rrugë dytësore janë të paasfaltuara, thotë një 18-vjeçar nga Kaçaniku, ndërsa një fermer nga Leposaviqi kërkon “rrugë të reja nga fshati në qytet” “Ekonomia do të përmirësohet nëse transporti do të ishte më i mirë” thotë një teknik nga Zveçani.

---

### **Fakte mbi transportin, posten, telekomunikacionin dhe teknologjinë informative**

---

- Kosova ka një rrjet rrugor prej 1700 km, 330 km hekurudhë, dhe një aeroport rajonal (UNMIK Departamenti i Rindërtimit).
- Është përgatitur një plan rimëkëmbjeje për hekurudhat e Kosovës i cili parasheh komercializimin e saj (BKK 2001)
- Aeroporti i Prishtinës rinisi veprimtarinë komerciale në vitin 2000. Ndërmarrja e aeroportit ka të ardhura nga tarifat e fluturimeve dhe të mallrave të transportuara nëpërmjet tij. Në aeroport kryhen mesatarisht 10 fluturime në ditë (BKK 2001)

---

<sup>8</sup> Shih Zërat e Zgjedhësve Brenga e Komunitetit, Departamenti i Demokratizimit MONK 2000

## *Brenga e Kosovës*

- Në Kosovë funksionojnë 110 zyra postare. Mund të dërgohen letra deri në 2 kg dhe pako deri në 2 kg. Nga 22 shkurti po shpërndahen dokumentet e identitetit, prej të cilëve janë shpërndarë rreth 700.000. Zyrat postare marrin në dorëzim pagesat për dokumentet e udhëtimit. (PTK)
- Linjat telefonike tokësore kanë 120.000 të abonuar dhe objektivi është shifra 450.000. 365 kabina telefonike do të instalohen së shpejti në zonat kryesore publike të Kosovës. (UNMIK Departamenti i Rindërtimit).



## AKTIVITETET ADMINISTRATIVE DHE OPERACIONALE TË DOGANAVE

Shumë pak pjesëmarrës në takimet e komuniteteve e morën parasysh këtë kompetencë. Vetëm në komunat në veri të lumit të Ibrit ato paraqitnin shqetësim, duke qenë se OKB kishte implementuar tarifa doganore për mallrat e importuara në Kosovë.<sup>9</sup>

Ky veprim nuk u miratua nga shumica e popullatës serbe të Kosovës, por njerëzit nga Lesaku në afërsi të Leposaviqit e shohin çështjen nga ana pozitive: “Ndryshimet e kohëve të fundit në politikën e taksave e ndihmojnë ekonominë dhe nuk mund të jenë aspak një pengesë për të. Na duhet një sistem më i mirë tatimor për mallrat e transportuara, kjo na ndihmon të kontrollojmë më mirë sistemin informal dhe të shfrytëzojmë mikrokreditin. Duhet të negociojmë përsa i përket kushteve më të mira për importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Njerëzit duhet të përfshihen më tepër në procesin e vendimmarrjes. Ne nuk duhet tu kundërvihemi masave të marra por të kërkojmë zgjidhjen ideale për komunitetin.” Fshatarët në Socanicë pranë Leposaviqit/Leposavic thonë se “sistemi i ri i taksave dhe doganave ka ndikuar në rritjen e vetëdijes politike të popullatës”. Ata sugjerojnë “të përshtatet sistemi i ri i taksimit sipas nevojave dhe të drejtave të njerëzve” dhe “të përdoren mënyra të tjera proteste përpara se qëndrimet negative të shprehen me anë të bllokimit të rrugëve.” Njerëzit nga Sokanica dëshirojnë marrëdhënie më të ngushta me zyrtarët dhe kërkojnë prej tyre “të komunikojnë më shpesh me ta përpara se të vendosin.”

Për një 41 vjeçar nga Peja/Pec, aktivitetet administrative dhe operative të doganave duhen për “mbrojtjen e prodhimeve të Kosovës.”

---

### Fakte

---

Shërbimet doganore të AQF vjelin 10% taksa për të gjitha importet (me përjashtim të ndihmave humanitare) AQF vjel akcizën në 15 kategori mallrash duke filluar nga 10% në pijet joalkoolike deri në 50% në karburante dhe alkool.

---

<sup>9</sup> Rregullorja e UNMIK-ut No 2000/55



## ADMINISTRATA LOKALE

*“Ata duhet ti njohin nevojat tona më së miri.”*

Një i ri nga Prishtina/Pristina

Administrata komunale është pjesa e qeverisë që u qëndron shumë afër Anjerëzve, por megjithatë shumë njerëz nuk e vënë re këtë. Personat të cilët i japin rëndësi përgjegjësive të administratës lokale kanë njëkohësisht edhe njohuri të mira përsa i përket kuptimit të pjesëmarrjes së qytetarëve. Për shembull, një grup fshatarësh nga Vacevo (pranë Leposaviqit) kërkojnë që “administrata lokale duhet ti përfshijë komunitetet në të gjitha aspektet e vendimmarrjes dhe duhet të financojnë iniciativat e qytetarëve,” dhe më tej “administrata lokale duhet tu flasë direkt qytetarëve përgjatë procesit të demoratizimit. Bashkëpunimi me qytetarët duhet të jetë më intensiv.”

Një avokat nga Kamenica dëshiron një administratë më moderne dhe aktive: “Administrata jonë lokale duhet të angazhohet në gjetjen e vendeve të punës. Ajo duhet të tregojë më tepër efikasitet dhe fleksibilitet gjatë procesit të privatizimit.” Rruga drejt demokracisë gjendet, sipas mendimit të një të punësuarit në sektorin e edukimit në Rahovec në transparencën dhe përgjegjësinë e administratës lokale e cila “duhet të punojë në mënyrë transparente. Nëse administrata lokale funksionon normalisht, ajo do të arrijë ta modernizojë vetveten, por një gjë e tillë mund të arrihet vetëm nëse luftohet korrupsioni.”

---

### Fakte mbi shërbimet e administratës publike

---

- Në sajë të ndihmës ndërkombëtare të emergjencës shumica e kompanive të mbledhjes së mbeturinave janë pajisur me makineritë e nevojshme dhe me një numër të mjaftueshëm kontainerësh të cilët mundësojnë një mbledhje të rregullt por rudimentare të mbeturinave shtëpiake (UNMIK Departamenti i Rindërtimit).
- Sasia e elektricitetit e marrë nga jashtë në tetor 2000 (280.000 MWh) ishte dyfishi i energjisë së blerë në tetor 1999 (160.000 MWh). Megjithatë, programi i riparimeve të emergjencës i sistemit të prodhimit të energjisë do të vazhdohet dhe Kosovës do ti duhet të mbështetet në energjinë e importuar. (UNMIK / JIAS Departamenti i Rindërtimit).
- Është riparuar sistemi i pompimit të ujit në Badovc si edhe 13 pompa nëpër komuna. (UNMIK / JIAS Departamenti i Rindërtimit). Që atëherë rezervat e ujit janë të mjaftueshme dhe mungesat e ujit janë shkaktuar nga shpërdorimet apo dëmtimet teknike të rrjetit.
- Sistemi i kanalizimit në Kosovë është i pazhvilluar, madje në mjaft vende nuk ekziston. (Raporti i CIMIC, Korrik 2001).



## TURIZMI

**T**urizmi u konsiderua prioritar në disa nga takimet e komunitetit. Kjo ka të bëjë me faktin se takimet u mbajtën gjatë sezonit veror. Kosova, sadoqë ka peisazhe tërheqëse, nuk mund të ofrojë shumë mundësi për pushuesit. Prindërit nuk dinë se ku ti kalojnë pushimet me fëmijët e tyre. Shumica nuk mund të udhëtojnë jashtë për shkak të kushteve financiare apo mungesës së vizave. Për këtë arsye është diçka me vend krijimi i mundësive për turizëm brenda Kosovës. “Pasuritë e shkëlqyera natyrore të Deçanit,” siç thotë me krenari një banor i atjeshëm, si edhe “bukuritë e Kosovës” siç shprehet një mekanik i vjetër nga Ferizaj/Urosevac duhet të përdoren sa më mirë që të jetë e mundur.

Ndoshta një ditë edhe të huajt do të vijnë të zbulojnë bukuritë e Kosovës.



## E ARDHMJA E KOSOVËS

*“Demokracia dhe Elektriciteti.”*

Student 22 vjeçar nga Lipjani/Lipljane

Gjatë mbledhjes së përbashkët të komuniteteve, pjesëmarrësve iu kërkua të shprehnin mendimet e tyre rreth të ardhmes së Kosovës. Për këtë arsye u parashtruan këto pyetje: “Çfarë mendoni për bashkëpunimin e popullit dhe liderëve të Kosovës? “Si mund të arrihet kjo?”

### **Pavarësia**

Ashtu siç ishte pritur nga shumica e popullatës së Kosovës, shqiptarët njëzëri u shprehën se brenda 5 viteve do të dëshironin ta shihnin Kosovën të pavarur. Fshatarët e fshatit Hani i Elezit (afër Kaçanikut/Kacanic) shprehën idealin e tyre: “Ne do të jemi të aftë të t’ia dalim mbanë, pasi për ne është gjithçka fitorja e Pavarësisë”. Për shumë nga pjesëmarrësit Pavarësia do të thotë “Antarësim i Kosovës në NATO dhe Unionin Evropian”, “Kushtetutë adekuate”, “Prosperitet ekonomik”, “Të drejta të barabarta për të gjithë,” dhe “Siguri për të gjithë”.

Përgjigja ndaj pyetjes se si mund të arrihet Pavarësia e Kosovës ishte: “përmes punës së palodhshme “dhe “të jemi të bashkuar”. “Populli dhe liderët e Kosovës do ta arrijnë pavarësinë,” shprehet një vajzë e re 19 vjeçare nga Malisheva/o. Politikanët duhet ta arrijnë pavarësinë brenda 5 viteve dhe kjo mund të bëhet vetëm nëpërmes punës së palodhshme. “Populli dhe liderët e Kosovës duhet ta bëjnë Kosovën stabile dhe kjo mund të arrihet përmes punës së palodhshme për një siguri më të lartë.”mendon një ekonomist nga Gjilani/Gnjilane.

Popullata e re e si në rastin e një automekaniku 19 vjeçar nga Lipjani/Lipljane mendon se pavarësia arrihet “nëpërmes paqes” Pavarësia është “një mjet nëpërmes të cilit mund të krijohet një shtet i zhvilluar”.

Pjesëmarrësit u shprehën se “shtetet e tjera janë duke i mbajtur ata nën vëzhgim, dhe për këtë arsye ata duhet t’i tregojnë botës se Kosova dhe populli i saj janë të aftë ta mbajnë dhe udhëheqin Kosovën e pavarur dhe të kujdesen për të drejtat e njeriut”. Një student 18 vjeçar nga Prizreni dhe një teknik 23 vjeçar nga Ferizaj/Urosevac theksojnë: “Është mirë që Kosova ti i tregojë botës se mund të qeverisë veten dhe t’i mbrojë dhe respektojë të drejtat e njeriut.” mendim me të cilin u pajtua edhe vajza 18 vjeçare nga Prizreni dhe një teknik nga Ferizaj/Urosevac. Disa prej tyre janë të shqetësuar duke qenë se politikanët e Kosovës shihen nga lat-poshtë nga të huajt, dhe në fakt vendasit nuk veprojnë ashtu siç mendojnë vetë por shkojnë në përputhje me udhëzimet e të huajve. Një

student i ri 23 vjeçar nga Kaçaniku/Kacanik thotë se: "Liderët nuk duhet ti përfillin aq shumë mendimet e të tjerëve sa që të mos e përfillin vullnetin e popullit të tyre i cili është Pavarësia e Kosovës. Me këtë mendim pajtohen edhe shumë pjesëmarrës tjerë në mbledhjet e komuniteteve.

Shumica e pjesëmarrësve mendojnë se për të arritur Pavarësinë duhet që populli dhe partitë politike të jenë të vetëdijshëm dhe të qendrojnë të bashkuar drejt këtij objektiv (studenti nga Lipjani/Lipljan).

Pavarësia ka një çmim shumë të lartë i cili nuk mund të shkëmbehet me asgjë. Arsimtari i shkollës fillore nga Sibofci i Epërm (Podujevë/o) dëshiron pavarësinë e Kosovës pa enklava.

### **Të drejtat e barabarta për të gjithë**

Pothuajse në të gjitha mbledhjet e komuniteteve ku merrnin pjesë edhe shqiptarët e Kosovës së paku një pjesëmarrës thoshte se Kosova e pavarur do t'u garantojë të gjithëve të drejta të barabarta pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare apo kombëtare.

"Ne është mirë t'i dëshmojmë botës se jemi në gjendje të kultivojmë dhe mbajmë demokracinë në një nivel të lartë, është mirë të krijojmë një shtet në të cilin të gjithë do të kenë të drejta të barabarta", deklaroi një farmacist i ri nga Prishtina/Pristine.

Një punëtor 37 vjeçar jep të njëjtën përgjigje si shumë të tjerë ndaj pyetjes se "Çfarë duhet të arrihet brenda pesë viteve të ardhshme"? – për të përgjegjja është e thjeshtë: "Të drejtat e njeriut për të gjithë". Kosova është mirë t'i respektojë të drejtat e minoriteteve. Është mirë që gjeneratat e ardhshme në Kosovë të kenë një perspektivë të barabartë pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare apo fetare" thotë një motër medicinale nga Ferizaj/Urosevac.

### **Komunitetet etnike**

Për komunitetet joshqiptare, pyetjet "Çka mendoni se është mirë të bëjnë populli dhe liderët e Kosovës brenda pesë viteve të ardhshme?" dhe "Si është mirë që të veprohet për të arritur këto objektivat?" na sjellin shumë përgjigje të ndryshme. Objektivat kryesore që duhet të arrihen brenda 5 viteve për pjesëmarrësit joshqiptarë janë siguria dhe mirëqenia për të gjithë.

Kërkesa e një 20 vjeçari nga Shtërpce /Sterpce i cili është automekanik është që "Populli të jetë i lirë në rrugë shtëpi e kudo tjetër. Ndërsa një polic i ri (poashtu nga Shtërpce/Sterpce) kërkon që "të gjitha komunitetet të jenë të lira dhe të kenë mundësi të jetojnë të lirë në Kosovë dhe të udhëtojnë të lirë në territorin e Kosovës". "Ata (politikanët e Kosovës) është mirë të formojnë një vend i cili më pak do t'i ngjante një burgu". Si?" nuk e dimë ende" tha një student 23 vjeçar i akademisë së arteve. Njëra nga qëllimet e komunitetit serbë është që brenda 5 viteve të ardhshme të kthehen të gjithë personat që janë zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Disa mendojnë se nuk kanë forcë që të ndikojnë në fushën e politikës apo të paktën janë të lodhur nga ndërhyrja në këtë sferë." ata thonë "ti lemë politikanët të ulen në tryezë së bashku dhe të i zgjidhin këto probleme", përmbledh fjalimin e tij një arsimtar i ri nga Shtërpca/Sterpce". Pavarësisht prej kësaj, njerëzit nuk kanë besim që të gjitha këto vendimë marrje t'ua lenë politikanëve." Shkalla e përgjegjësisë politike është shumë e ulët, kurajoja e politikanëve është poashtu shumë e vogël. "Liderët në fakt duhet t'i përfillin dëshirat dhe vullnetin e popullit".

“Megjithatë mendoj se Kosova pas 5 vitesh nuk do t’i ngajë Kosovës së sotme” shprehet një advokat nga Globoçica afër Dragashit/Dragas).

“Përsa i përket serbëve të Kosovës nuk ka ndonjë shpresë për një jetë më të mirë” Ne nuk e dimë se sa arsimtarë serbë të Kosovës pajtohen me këtë mendim, por megjithatë në këtë mbledhje dominoi një ide optimiste. Urrejtja duhet të harrohet dhe këtë mund ta bëjmë duke u nisur nga vetvetja”, thekson një arsimtar tjetër. Para së gjithash është mirë të mundohemi dhe të jetojmë së bashku” Nëse nuk kemi garanci për jetesë, ne së paku është ta gjejmë një kënd diku për antarët tanë të familjes të cilët janë shpërndare si zogjtë“ ( tha një motër medicinale nga Shtërpca/Sterpce).

Minoritetet e Kosovës nga e ardhmja e Kosovës presin që të veprohet në mënyrë të barabartë ndaj cdo qytetari të Kosovës, të dënohen ekstremistët dhe të largohen armët nga Kosova. Të vendosen mardhënje ekonomike në mes të komuniteteve të ndryshme turistike dhe mardhënje të ndryshme në laminë e biznesit” janë propozimet e një 44 vjeçari.

Një mekanik nga lokaliteti i serbëve në Rahovec/Orahovac nuk do asgjë më tepër se “paqe për të gjithë” dhe “ brenda 5 viteve të ardhshme plagët e luftes është mire të sherohen dhe njerëzit t’i kthehen jetes normale dhe detyrave rutinore”. Para së gjithash komunitetet eshte mire qe të punojne ne krijimin e nje atmosfere më të mirë ndëretnike në Kosovë. Si? Pa dyshim se me kalimin e kohës, gradualisht, ndoshta në fillim nëpërmes mediave, duke insistuar në tolerancën ndëretnike” propozon një ri i punësuar në KFOR në Shtërpçë/Sterpce.

### **Kosova dhe RFJ**

Pa dyshim për shumë serbë të Kosovës lidhjet e Kosovës me Serbinë dhe Jugosllavinë janë ende të forta dhe ata theksojnë se të gjithë politikanët është mirë të punojnë së bashku, ata të Jugosllavisë dhe të Kosovës, “dhe të shohim që brenda 5 viteve do t’u tregojmë shqiptarëve se jeta e përbashkët është e mundshme nëse ne e përfillim ligjin”, tha një (inxhinjer 46 vjeçar). Kështu që “rintegrimi i Kosovës në sferën e politikës, kulturës, mund të bëhet përmes proceseve tjera demokratike me RFJ-në”, tha një arsimtare serbe 26 vjeçare e historisë.

Një student serb i muzikës thotë se “nëse partitë politike tregojnë jotolerancë dhe e çojnë Kosovën drejt një ndarje atëhere masa të ashpra dhe sanksione paraprake do të ndermirren. Komuniteti i Globoçicës (Dragash/Dragas) dëshiron që statuti final i Kosovës të zgjidhet sa më parë” dhe nëpërmes proceseve vendim-marrëse liderët do të “konsiderojnë çështjet e religjionit” shprehet një mjeke.

“Nëse statuti final i Kosovës do të jetë shtet multietnik dhe në Kosovë do të mbizotërojë paqja dhe toleranca, ku njerëzit do të mund të jetonin së bashku, atëherë do të jemi në një rrugë e cila do të na shpie drejt Evropës” thotë me një bindje të plotë një student i mjeksisë nga fshati Goran. Një motër medicinale dëshiron që brenda 5 viteve të ardhshme në Kosovë të arrihet “një demokratizim i tërësishshëm i shoqërisë, të respektohen të drejtat njerëzore, të mbizotërojë ndjenja e qetësisë, e drejta dhe mundësia për të gjithë njerëzit për të punuar, si dhe mundësia e shkollimit të fëmijëve.

Një qytetarë nga Brod (Dragash/Dragas) i nxit qytetarët dhe politikanët që “të mos humbasin energji dhe kohë për kaos. Ai thotë se ne kemi nevojë për bashkëjetesë, të drejtën e punës, lirinë e lëvizjes, dhe shkollimin, kjo është ajo për çfarë kemi nevojë,” përfundon ai. Ndërsa një biznesmen nga Dragashi thotë

”nëse njerëzit e Kosovës kanë besim dhe siguri të plotë atëherë rruga për ta arritur qëllimin nuk është aq e gjatë”

### **Zhvillimi ekonomik**

Kur bisedohet për të ardhmen e Kosovës jo të gjithë pjesmarrësit janë të bren-gosur për çështjen politike. Shumë shpesh gjendja ekonomike është poashtu prioritet. E njëjta gjë e preokupon një pensioner 70 vjeçar nga Reçani/Recane (Prizren) i cili thotë se “brenda 5 viteve është mirë të arrihet një nivel ekonomik i cili i garanton të gjithëve një standard me të lartë jetësor. Një njeri i vjetër nga fshati Sibofc i Epërm (Podujeve/o) thekson se politikanët “duhet të punojnë shumë për ta zhvilluar vendin, dhe ta bëjnë Kosovën të pavarur nga donatorët e huaj.” Ndërsa një agronom nga Kaçaniku/Kacanik dëshiron që “brenda 5 viteve të zgjidhet problemi i papunësisë, të bëhet ristrukturimi i infrastrukturës, dhe t’u jepen pensionet pensionistëve. Në të njejtën kohë ai dëshiron që të jetojë në një vend ku ligji do të mbizotërojë dhe përfillet nga të gjithë. Për një student 19 vjeçar nga Prizreni me rendësi të veçantë është “zhvillimi i industrisë, i tregtisë me botën e jashtme, shkollimi dhe shkenca, së bashku me zhvillimin e institu-cioneve. Kjo do të na shpjerë në një qeverisje të mirë.”

Një sekretare 24 vjeçare nga Kaçaniku/Kacanik thotë “Unë mendoj se populli i Kosovës dhe liderët e saj është mirë të përqendrohen në riparimin e rrugëve, të bëjnë parkingje të reja dhe një sistem funksional kanalizues dhe një rrjet më të mirë të elektricitetit”. Një fshatar nga Prapaqani (Deçan) shpreson se “prosperiteti ekonomik i Kosovës nuk do të mbetet vetëm ëndërr.”

# Mirënjohje

Kjo broshurë është kryesisht fryt i punës së zyrtarëve të Departamentit të Demokratizimit që bashkëvepron me Zyrat vendore dhe ato regjionale të OSBE-së. Shumë organizata joqeveritare vendore dhe grupe qytetarësh si edhe organizata tjera kanë dhënë kontributin e tyre në takimet e komuniteteve për të gjetur zgjidhjet adekuate. Ne dëshirojmë që ti falënderojmë ata dhe u jemi mirënjohës të gjithëve.

Falënderojmë zotin Peter Kollier për kontributin e dhënë për këtë projekt. Departamentin për të Rinjë, Arsim, Shkencë, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Punësim UNMIK/JIAS.

Autoritetin Qendror Fiskal.

Policin e UNMIK-ut (POL-PRESSE)

Karabinierët e Njësisë Speciale Multinacionale. (Unità di manovra)

Organizatën ndërkombëtare për Migrim

Nëna Terezë

Handikos

Grupi rural verior i të rinjëve, Prishtinë/Pristina

OJQ e Grave Podujevë/Podujevo

OJQ e Grave “Liria” Suharekë/Suvarëka

OJQ e Grave “QMGF” Suharekë/Suvarëka

Shoqata “Rimëkëmbja ekonomike e bujqësisë”, Suharekë/Suvarëka

OJQ “Legjenda” – Vitia/Vitina

OJQ “Arbëria”, Istog/Istok

OJQ “Amica” Rahovec/Orahovac

OJQ “Malteser” Ferizaj/Urosevac

IMC Qendra e Rinisë, Ferizaj/Urosevac

OJQ “Gratë në veprim”, Kaçanik/Kacanik

OJQ “Sofra”

Qendra e shëndetit, Kaçanik/Kacanik

“Agroklima” Klinë/Klina

Grupi i grave “Vicianët”, Vushtrri/Vucitrn

Shoqata e farmerëve “Viktoria Ko”, Prapaqan (Deçan/Decani)

Shoqata e grave “Besa”, Deçan/Decani

Qendra për trajnime profesionale për gra, Gjakovë/Djakovica

Jeta ime , Gjakovë/Djakovica

Qendra për mbrojtje për gra dhe fëmijë, Gjakovë/Djakovica

Shoqata e grave për biznes, Gjakovë/Djakovica

Grupi Kosovar i të rinjëve, Gjakovë/Djakovica

Rinia multi-etnike, Gjakovë/Djakovica

Këshilli i Studentëve, Gjakovë/Djakovica